

Debati në Kuvendin e Shqipërisë “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar

Seanca e pasdites, e hënë, 21.04.2008

**Jozefina Topalli** - Pika e tretë e rendit të ditës: Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar”.

Urdhëroni, zoti Braho!

**Spartak Braho** – Përveç problemit që ky ligj është futur në kundërshtim me Rregulloren, nenin 97, pasi duhen dy javë, unë do t’ju vë në dukje, zonja Kryetare, që përsëri vazhdoni me shkelje të rënda të Rregullores së Kuvendit. Tani sapo na është shpërndarë mbi tavolinë një draft i ri, ku është vënë për shqyrtim neni 67 i Kushtetutës, nen i cili s’ka qenë bërë fare objekt i Komisionit të Ligjeve. Nuk e di se ku e gjeni këtë të drejtë. Duhet të mblidhet Komisioni i Ligjeve që ta shqyrtojë.

**Jozefina Topalli** - Falemnderit!

Urdhëroni, zoti Beja!

**Fatos Beja** – Falemnderit, zonja Kryetare!

Unë gjykoj që është mirë të lexojmë raportin e komisionit, që të mos ketë më keqkuptime dhe keqinterpretime, siç ndodhi në këtë sekondë.

**Jozefina Topalli** – Dakord.

Zoti Beja do të lexojë raportin.

**Fatos Beja** – Zonja dhe zotërinj deputetë,

Zonja Kryetare,

Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe i të Drejtave të Njeriut, në mbledhjen e datave 7, 9, 14, 16 dhe 18 prill 2008, në cilësinë e komisionit përgjegjës, mori në shqyrtim projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar”, nismë e më shumë se 1/5 e deputetëve të Kuvendit në datën 17 mars 2008.

Komisioni i Ligjeve, në mbledhjen e datës 7 prill, përcaktoi procedurën për shqyrtimin e amendamenteve të propozuara për ndryshimin e Kushtetutës nga Grupi Parlamentar i PS-së. U caktuan dy relatorë, zonja Trashani dhe zoti Xhafaj, respektivisht nga grupet parlamentare të PS-së dhe PD-së. Amendamentet e propozuara nga Grupi Parlamentar i PS-së, të firmosura nga më shumë se 1/5 e deputetëve, kishin në fokus të tyre ndryshimin e modelit të sistemit zgjedhor të përcaktuar në Kushtetutë. Kështu nga sistemi i përzier maxhoritar-proporcional, që parashikon Kushtetuta aktuale, propozohet sistemi proporcional me zona zgjedhore shumemërore.

Në mbledhjen e datës 9 prill, në Komisionin e Ligjeve u zhvillua diskutimi në parim i projektamendamenteve të Kushtetutës. Relatorët e caktuar nga komisioni bënë komentet e tyre rreth amendamenteve të propozuara dhe mbi bazën e konsultimeve paraprake paraqitën disa propozime të reja në komision.

Gjatë diskutimit në parim të amendamenteve të Kushtetutës morën pjesë në mbledhjen e komisionit edhe përfaqësues nga partitë e tjera parlamentare, si deputetët Ceka, Starova, Shpani, Gjini etj., të cilët shprehën opinionet e tyre në lidhje me amendimin e sistemit zgjedhor në Kushtetutë. Gjithashtu, anëtari i komisionit, zoti Braho, depozitoi një amendament për nenin 64 të Kushtetutës.

Në mbledhjen e datës 14 prill, Komisioni i Ligjeve vijoi me shqyrtimin nen për nen të amendamenteve të paraqitura tashmë nga deputetët e të dyja grupeve parlamentare. Relatorja Trashani, në emër të grupit të deputetëve të PD-së, deklaroi heqjen dorë nga propozimi për amendimin e nenit 93 të Kushtetutës, që kishte të bënte me kundërfirmimin e dekretëve të Presidentit. Komisioni miratoi nenet e riformuluara nga të dy relatorët, si dhe propozimin për shfuqizimin e pjesës së 12-të të Kushtetutës.

Në mbledhjen e datës 16 prill, Komisioni i Ligjeve vijoi me shqyrtimin e neneve të tjera të propozuara nga deputetët e Grupit Parlamentar të PD-së. Diskutimi në komision

u zhvillua mbi bazën e një teksti të integruar me propozimet e të dyja palëve, të cilat u formalizuan me firmat e më shumë se 1/5 së deputetëve.

Projektligji i integruar shoqërohet nga një relacion shpjegues, i cili jep argumentet juridike për domosdoshmërinë e amendamenteve të propozuara. Përveç komenteve për sistemin zgjedhor, relacioni sqaron edhe propozimet e reja për procedurën e zgjedhjes së Presidentit të Republikës, me qëllim shmangien e krizave politike dhe institucionale të panevojshme, të cilat do të çonin në zgjedhje të parakohshme. Gjithashtu, propozimet për ndryshimin e neneve 104 dhe 105 të Kushtetutës, që kanë të bëjnë me mocionin e besimit të Kryeministrit të vendit dhe me mocionin e mosbesimit të paraqitur nga 1/5 e deputetëve, synojnë shmangien e krizave institucionale, që vijnë si rezultat i presioneve politike të koalicioneve qeverisëse, dhe rritjen e stabilizimit të qeverisjes së vendit. Duke përcaktuar një mandat kohor për Prokurorin e Përgjithshëm, propozuesit synojnë të sjellin edhe këtë institucion në të njëjtën linjë me të gjitha institucionet e tjera kushtetuese të cilat kanë mandate të përcaktuara.

Komisioni diskutoi dhe votoi në datën 14 prill nenet 1, 6, 9, 10 dhe 11 të projektligjit. Relatorët u ngarkuan të saktësojnë formulimin e neneve të tjera mbi bazën e sugjerimeve që u bënë në komision.

Në këtë mbledhje deputeti Braho depozitoi një amendament tjetër në lidhje me nenet 87 dhe 149 të Kushtetutës.

Në mbledhjen e datës 18 prill, anëtarët e Komisionit të Ligjeve rimorën në shqyrtim vetëm nenet për të cilat kishin punuar relatorët, konkretisht nenet 2, 3, 4, 5, 7 dhe 8 të projektligjit.

Në këtë mbledhje, në lidhje me nenin 5 të projektligjit, që ndryshon nenin 87 të Kushtetutës për procedurat për zgjedhjen e Presidentit të Republikës, një grup prej më shumë se 1/5 e deputetëve të Kuvendit depozituan në komision një amendament për ndryshimin e këtij neni, i cili kishte në thelb të tij zgjedhjen e Presidentit nga populli. Pas votimit në komision, amendamenti, me 13 vota kundër dhe 5 pro, nuk u miratua nga Komisioni i Ligjeve.

Komisioni, me 13 vota pro dhe 5 kundër, miratoi amendamentin e paraqitur në tekstin integral të projektligjit, sipas propozimit të dy relatorëve.

Në përfundim të shqyrtimit të projektligjit, me votimin në tërësi me 16 vota pro dhe 2 kundër, Komisioni i Ligjeve u shpreh dakord që ky projektligj të kalojë për miratim në seancë plenare.

Drafti përfundimtar i integruar, i miratuar nga Komisioni i Ligjeve dhe i mbështetur për çdo nen me firmë të mbi 28 deputetëve, nga ana formalo-juridike është në përputhje me Kushtetutën, nenin 177.

Komisioni i Ligjeve ka respektuar të gjitha procedurat e parashikuara në Rregulloren e Kuvendit, sipas krerëve V dhe VI të saj.

Dispozitat e projektligjit, që i paraqiten seancës plenare për miratim me shumicën e cilësuar prej 2/3 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, janë firmuar nga më shumë se 1/5 e të gjithë deputetëve.

Zotërinj deputetë, ky ishte raporti i komisionit. Bashkëngjitur këtij raporti vini atë tekst integral që është shpërndarë në Kuvend, i cili është tërësisht në përputhje me vendimet që janë marrë në komision, në ato data për të cilat fola më lart.

Neni, për të cilin foli zoti Braho, është miratuar në komision. Diskutimin dhe votimin mund t'i gjeni te procesverbalet. Zoti Braho t'i shikojë, po të dojë.

**Jozefina Topalli** – Zoti Bejtaj.

**Engjell Bejtaj** – Falemnderit, zonja Kryetare!

Në vijim të diskutimit që kam bërë sot në Konferencën e Kryetarëve, do të thosha që propozimet për ndryshime në Kushtetutë, si projektligj, kanë defekte të karakterit procedural.

Së pari, që një projektligj i zakonshëm të vijë për t'u votuar këtu në Parlament, minimalisht duhet të qëndrojë dy javë për diskutim në komisione, derisa të maturohet për të ardhur këtu. Mendo pastaj sesi duhet të trajtohet një projektligj, ku bëhet fjalë për

ndryshim të Kushtetutës. Këtë e kam vënë në dukje dhe sipas opinionit tim propozimi i Grupit Socialist, për ndryshimet në Kushtetutë që lidhen me reformën zgjedhore, e plotëson afatin e kërkuar për t'u votuar, ndërsa propozimet e tjera, të cilat i janë bashkëngjitur këtij propozimi, ende nuk janë maturuar. Këtë jua thashë dhe e përsëris edhe një herë për dijeninë e të gjithë deputetëve.

Nga ana tjetër, pas daljes nga Konferenca e Kryetarëve kam kërkuar të marr një kopje të draftit përfundimtar me ndryshimet e propozuara, por nuk kam pasur mundësi ta marr, pasi nuk ishte gati. Sipas Rregullores, ai draft duhet të ishte gati jo më vonë se 3 ditë. Pra, 3 ditë përpara seancës plenare që do t'i votonte ato ndryshime, drafti duhet të ishte në dorë të deputetëve. Për këtë kam dëshmitarë edhe punonjësit e drejtorisë që përgatitin seancat plenare që unë nuk kam pasur mundësi ta marr. Jam i bindur që nuk është përgjegjësi e tyre, pasi ata bëjnë vetëm anën praktike të shpërndarjes, por ka qenë çështje e formulimeve, midis të tjerave edhe e asaj që ngriti zoti Braho.

Unë ju bëj thirrje që minimalisht për Kushtetutën, për ndryshimet e saj të respektohen afatet që parashikon Rregullorja. Nuk ndodh asgjë nëse respektohet Rregullorja, sepse është e tepërt, të paktën për këtë seancë, të them se ndryshimet e Kushtetutës duhet të kishin kaluar nëpërmjet një procedure krejt ndryshe, në respekt të këtij dokumenti dhe të paktën të jepnin mesazhin që kjo Kushtetutë këtej e tutje nuk do të shkelet siç është shkelur deri më sot.

**Jozefina Topalli** – Falemnderit, zoti Bejtaj!

Zoti Legisi e ka fjalën.

**Ndre Legisi** – Zonja Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Të gjithë jemi në dijeni të një amendamenti të depozituar për ndryshimin e nenit 87 të Kushtetutës nga një grup deputetësh. Këtë e kanë dhënë të gjitha mediat dhe është diskutuar edhe në Komisionin e Ligjeve, por nuk është këtu në Kuvend. Në Komisionin e Ligjeve është vendosur që të dyja variantet të kalojnë në Parlament. Unë e kam materialin dhe nuk e kuptoj se me çfarë të drejte është hequr si amendament për të konkurruar. Është në dijeni i gjithë opinioni publik që ka pasur një grup deputetësh që kanë mbrojtur amendamentin për zgjedhjen e Presidentit nga populli.

Falemnderit!

**Jozefina Topalli** – Falemnderit, zoti Legisi!

Zoti Shehu e ka fjalën.

**Sali Shehu** – Falemnderit!

Të nderuar kolegë,

Me korrektësi kryetari i Komisionit të Ligjeve bëri prezent se në Komisionin e Ligjeve është depozituar një nismë e më shumë se 1/5 e deputetëve të Kuvendit, e cila është në formën e një amendamenti konkurrues me amendamentin që është paraqitur për nenin 87. Unë mund t'ju them se, megjithëse është e vërtetë që Komisioni i Ligjeve e ka votuar me 13 vota kundër dhe 5 pro, neni 177 i Kushtetutës, pika 1 thotë: "Nisma për rishikimin e Kushtetutës mund të ndërmerret nga jo më pak se 1/5 së anëtarëve të Kuvendit". Komisioni i Ligjeve nuk ka fuqi ta ndalojë këtë nismë.

Falemnderit!

**Jozefina Topalli** – Falemnderit!

Zoti Ngjela e ka fjalën.

**Spartak Ngjela** – Zonja Kryetare,

Me keqardhje dua t'ju paralajmëroj se kjo mënyrë procedurale për ndryshimin e Kushtetutës është krim penal. Kush e merr përsipër le ta marrë. Shkelja e procedurave për miratimin e Kushtetutës dhe prekja e saj në mënyrë arbitrare sot ka në proces penal Presidentin e Turqisë, Kryeministrin e Turqisë dhe të gjithë parlamentarët që e kanë ndërmarrë.

Ju lutem, nuk ka nevojë për ilaritet, por jam i detyruar t'ju njoftoj se Kushtetuta dhe platformat mafioze kanë procedura të ngadalta. Procedurë kaq të shpejtë prej cubash të Kushtetutës, vetëm ata që e kanë shkelur penalisht bëjnë. Po të jeni aq të fortë

vendoseni, vetëm se duhet të dini një gjë: duhet të shkoni me shpresën që në Shqipëri nuk do të vendoset kurrë ligji.

Për sa i përket nismës, ku kam firmuar edhe vetë, jeni të detyruar të na e sillni në sallë.

**Jozefina Topalli** – Falemnderit!

Zoti Ceka e ka fjalën.

**Neritan Ceka** – Zonja Kryetare, besoj se do të jepni përgjigje dhe mos kërkonit më diskutime. Nisma e 28 parlamentarëve duhet të jetë këtu. Çdo vazhdim i seancës është pa kuptim. Ju lutem, ndërprisni seancën, të vijë amendamenti, siç është propozuar nga deputetët, që të mund të vazhdojmë seancën.

**Jozefina Topalli** – Zoti Koçi.

**Petro Koçi** – Zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Kjo seancë nuk më duket si seancë e rregullt parlamentare, ku ndërmerret një hap shumë i rëndësishëm, por si një seancë funerali. Unë dua të jepni përgjigje lidhur me faktin, nëse do të ketë debat për ndryshimet kushtetuese apo jo, sepse ne nuk po shqyrtojmë një ligj mbi gardianin e Kryeministrit, ne po shqyrtojmë një ligj për kartën themelore të shtetit. Kjo është karta që garanton jetën e gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë.

**Jozefina Topalli** – Falemnderit!

Në Konferencën e Kryetarëve është vendosur që grupet e vogla të flasin 10 minuta, megjithatë këtu do të flitet për Kushtetutën dhe unë do t'u jap mundësi deputetëve të shprehen.

Ka diskutime? Zoti Ngjela e ka fjalën.

**Spartak Ngjela** – Të nderuar kolegë,

Zonja Kryetare,

Më lejoni t'ju jap kurajë se keni një seancë të vështirë sot në sensin historik.

Zotërinj, përpara disa ditësh në këtë Parlament kam shprehur gjykimin tim, të cilin dua ta përsëris. Një Parlament që nuk është në gjendje të interpretojë vullnetin e popullit të vet, nuk ka karakter demokratik në vetvete. Do ta them sa herë që të shkelen normat e Kushtetutës. E njëjta gjë po ndodh edhe sot. Me keqardhje konstatoj, të nderuar kolegë, se në këtë Parlament nuk përfillet fare vullneti i popullit. Provë më të madhe se kjo, që një Kushtetutë të kalojë në hije, pa asnjë analizë, pa asnjë komision ekspertësh dhe pa bërë fare asnjë analizë për aplikimin e saj disavejeçar, për të mos thënë 9-veçar, nuk ka. Të gjitha këto të japin të kuptosh se jemi përballë një agresioni të madh kundër lirisë.

Në lidhje me këtë më lejoni, zotërinj të nderuar, të shpjegoj se cilat mund të jenë pyetjet brenda të cilave mund të përmblihet diskutimi parlamentar në lidhje me amendamentet kushtetuese që janë paraqitur ndërkaq:

1. Si paraqitet aplikimi i Kushtetutës në nëntë vitet e funksionimit të saj? A ka ndonjë ekspertizë për të ?

2. Pse duhet ndryshuar neni 87 i Kushtetutës, që parashikon modalitetet e zgjedhjes së Presidentit, në një kohë që Presidenti ka edhe një afat 4-veçar, pra kemi minimumi tre vjet për të biseduar apo diskutuar për një dispozitë të tillë?

3. A kemi një studim nga autoritetet kushtetuese në lidhje me ndonjë kontradiksion që mund të jetë konstatuar për çështjen e Presidentit dhe zgjedhjen e tij?

4. A ka konceptsin ky Parlament dhe a mendon se cila ka qenë arsyeja pse Presidenti duhej të zgjidhej me tri të pestat, si argument që është dhënë në përpilimin dhe miratimin e kësaj Kushtetute?

5. Si ka mundësi që dy nene kushtetuese, që nuk janë zbatuar asnjëherë në këta nëntë vjet, përkatësisht nenet 104 dhe 105 të Kushtetutës, që flasin për mocionin e besimit dhe mosbesimit, të reduktohen derisa të mos gjejnë më zbatim në ecurinë politike dhe demokracinë në vijim?

Para se t'u përgjigjem këtyre pyetjeve, të cilat do të përbëjnë një analizë timen konstitucionale dhe politike njëherësh për këtë çështje, më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj dy ngjarje tiranike, që i kanë ndodhur botës shqiptare dhe shtetit shqiptar në këta 50 vjet pas gjëmës komuniste, e cila, natyrisht që është konstante.

Zotërinj, heqja e autonomisë së Kosovës nga parlamenti kukull i Kuvendit të Kosovës dhe referendumi i Kushtetutës i vitit 1994, që nuk u lejua të kalonte në këtë Parlament, sepse Kushtetuta do të rrëzohej, janë dy pika të errëta që historia jonë kombëtare do t'i njollosë si tiranike. Amendamentet kushtetuese, të paraqitura për diskutim në këtë seancë, përbëjnë pikën e tretë të errët, në rast se do të miratohen nga ky Kuvend. Diktaturat dhe tiranët, tiranët si rregull, kanë gjetur mbështetjen për diktatorë dhe tiranë të dy tipa parlamentarësh: të korruptuarit dhe të tremburit. Nuk dua të bëj analiza, gjejeni vetë veten ku ndodheni. Koha do të tregojë qartë atë që thashë.

Më lejoni t'u përgjigjem pyetjeve për analizën time konstitucionale.

E para, që është më e rëndësishmja (se është paraqitur edhe një amendament me tridhjetë firma që nuk kalon në sallë. Guxoni të mos e kaloni!), si paraqitet aplikimi i Kushtetutës në nëntë vitet e funksionimit të saj? Nuk kemi asnjë analizë korrekte dhe asgjë nuk thuhet në relacion për këtë çështje. Kushtetuta ka pasur shumë kontradiksione, ka pasur konflikte të brendshme deri atje sa mund të na çonin në përplasje të mëdha. Por asnjë nga këto nene nuk ka qenë problem. Megjithatë, më gjeni platformën e kritikizmit ku mbështetet hartimi i amendamenteve që kemi para.

E dyta, pse duhet të ndryshohet neni 87 i Kushtetutës, që parashikon modalitetet e zgjedhjes së Presidentit? Zotërinj, jua them unë se pse. Nuk kam fakte, por kam thirrur në ndihmë dy njerëz të mëdhenj për të dhënë konkluzionin tim: Aristotelin për silogjizmin e tij dhe Bertrand Rasëllin për inferencën e tij. Më lejoni të arsyetoj logjikisht. Ç'është kjo ngutje kur kemi ende edhe katër vjet për të diskutuar për procedurën e zgjedhjes së Presidentit? Jua them unë pse. Sepse kërkohet të rrëzohet Presidenti aktual. Ju do të pyesni: pse? Kërkohet të rrëzohet Presidenti aktual sepse vjedhjet, Gërdeci, shumë gjëra, kërkojnë bunker presidencial. Nuk do t'i gjejnë dot. Le ta rrëzojnë Presidentin po të duan. Do ta shikoni se si do të vijë procedura. Sepse përsëri silogjizmat dhe logjikat moderne na thonë se pse nuk prisni tre vjet. Madje nuk prisni dot as tri ditë. Ç'është kjo ngutje, zotërinj? Mos keni bërë pazare? Jua them më poshtë se cilat janë pazaret. Prapë me logjikë. Mua më ka dalë logjika e Aristotelit, do ta dëgjoni që do të më dalë edhe kjo.

E treta, a e koncepton dot ky Parlament se cila ka qenë arsyeja pse Presidenti duhej të zgjidhej me tri të pestat? Jua them unë: sepse s'kemi senat. Sepse po të kishte senat, do të kishim konsensus permanent. Sepse këtu palët nuk pranuan të kishte senat. Atëherë ne nxorëm një President të fortë. Gaboheni që mendoni se kemi President të dobët. Kemi një President shumë të fortë, që është më i fortë nga të tërë ata që keni shkruar në atë letër dhe ku mendoni se mund t'i imitoni. Dhe e kemi të fortë Presidentin sepse nuk shkarkohet dot. Akuza kundër tij duhet të bëhet në Gjykatën Kushtetuese. E kemi të fortë Presidentin, sepse ai ka në dorë gjithë pushtetin gjyqësor, sepse ia kemi dhënë me koshiençë edhe prokurorinë, në kontrollin e saj dhe në emërimet. Pse? Se nuk kemi senat.

Atëherë, pse duheshin tri të pestat? Që ky President të mos dilte politik, por me konsensus. Tani duan ta bëjnë politik, me 70 plus 1. Pra, që këto kompetenca t'i ketë një njeri, i cili nuk ka arritur konsensusin. Ndërsa këtu ka një amendament që ia kërkon popullit, kështu ka qenë diskutimi, ose me tri të pestat dhe në zgjedhje, ose direkt te populli. Pse trembeni nga populli dhe keni hequr amendamentin? Turp! Ç'është ky Parlament që trembet nga populli i tij? Ç'është kjo? Kjo është një gjëmë. Unë nuk di pse e duroni! Si mund të hiqet amendamenti kushtetues që i drejtohet popullit për zgjedhjen e Presidentit?

Dhe s'e kanë fajin ata që e kanë nënshkruar, por ata që nuk presin tre vjet të diskutojnë një nen, por na e bien sot. Pse? Sepse duan të bëjnë pazare për nene të tjera, për të cilët kanë interesa me njëri-tjetrin. Mos vallë Kushtetuta është monedhë tregu?

Ajo është vullneti i popullit dhe nuk duhet cenuar. Është kontrata shoqërore e shqiptarëve dhe konstitucionalizmi, që ju e përmendni shpesh këtu, jua shpjegoj qartë se ç'është: është mbrojtja e interesave të pakicës, deri tek individi. Maxhoranca ka mbrojtje demokracinë, minoranca ka mbrojtje konstitucionalizmin, dhe këtu po goditet minoranca.

Dhe e fundit, si ka mundësi që dy nene, që nuk janë aplikuar asnjëherë, nenet 104 dhe 105 për mocion mosbesimi, të ndryshojnë? Gjejeni vetë përgjigjen! Unë nuk mund ta gjej derisa bien kambanat e mungesës së kohës.

Falemnderit!

**Jozefina Topalli** – Falemnderit, zoti Ngjela!

Zoti Ceka.

**Neritan Ceka** – Të nderuar kolegë,

Fjala ime do të jetë e shkurtër, sepse shumë pika u prekën nga zoti Ngjela, me të cilin ndaj po ato mendime.

Besoj se dita e sotme është një reflektim jo vetëm në këtë sallë, por edhe për tërë qytetarët që na ndjekin. Është me gjithë mend një përfaqësim i mendimeve, i nevojave që kanë ata që na kanë sjellë në këtë sallë. Mendoj se mënyra sesi po veprojmë, procedurat, janë larg asaj që presin zgjedhësit tanë. Demokracia, në radhë të parë, është procedurë. I njëjti vendim, i marrë me shpejtësi, diskreditohet dhe nuk bëhet demokratik; po ai vendim, i marrë me procedura të rregullta, fiton legjitimitetin demokratik. Sot jemi në nxitim. Do të thosha që sot do të ishte mirë të merrnim edhe një vendim tjetër, të shkruanim në hyrjen e këtij Parlamenti: “Nxito me ngadalë”.

Pra, në punën tonë nuk do të rrimë në vend, por edhe për të nxituar në këtë mënyrë nuk mund ta bëjmë. Natyrisht, procedurat (nuk ka nevojë të argumentoj edhe një herë atë që është thënë, në media është konstatuar që këtu procedurat nuk janë respektuar), të krijuara nga vetë ndërtimi i Kushtetutës, pasi ka kaluar një vit diskutime, janë ftuar edhe faktorët e interesit, është ftuar edhe Komisioni i Venecias, që është partner, bashkautor i kësaj Kushtetute, duhej patjetër që të kishin kohën e nevojshme për diskutim. Unë nuk e kuptoj pse nuk e kemi bërë këtë.

E dyta, më bën përshtypje mungesa e profesionalizmit. Për disa propozime që hidhen duhej të ishin përjashtuar disa deputetë nga kjo sallë. Besoj se ai deputet, që ka propozuar që të kundërfirmosen dekretet e Presidentit, duhet të ikë nga kjo sallë, sepse kjo është një gafë që do të linte në klasë edhe studentin e vitit të dytë. Në vitin e parë mbase do ta kalonin për mëshirë.

Mendoj se këtu janë parashikuar disa situata virtuale. E tha edhe zoti Ngjela, ne nuk kemi pasur as mocione mosbesimi, as votëbesimi, s'kemi pasur kurrë zgjedhje të parakohshme, të provokuara nga ky Parlament dhe unë nuk e di pse ne duhet të mblidhemi sot, të hyjmë në sherr me njëri-tjetrin, për të miratuar një gjë që s'ka ngjarë dhe ka shumë pak gjasa të ngjajë. Kjo është një Kushtetutë shumë e mirë, mund t'jua them nga përvoja ime, është e balancuar, është ndërtuar mbi parimin demokratik “kontrollo dhe balanco”, një parim amerikan. Pra, çdo prekje në një pikë të institucioneve, reflektohet negativisht në balancën ose kontrollin. Besoj se ky është dëmi më i madh që do të bëjmë nëse do ta prekim Kushtetutën me mënyrën që po bëhet, me duar të pastërvitura. Nuk po flas për një situatë kur do të na qeshin nesër.

Thuhet se mocioni i mosbesimit paraqitet vetëm atëherë kur kemi gati kryeministrin e ri, votohet edhe kryeministri që është në detyrë dhe pastaj ky mund të ikë dhe vjen i riu. Por unë po ju pyes: ja, i siguroi 71 vota ky grup dhe e zgjodhi kryeministrin e ri me një procedurë që nuk figuron në Kushtetutë (Kushtetuta e ka të saktësuar mënyrën sesi zgjidhet kryeministri, por e zëmë se e bëmë dhe kryeministri i vjetër, ai që pret të largohet, siç ndodh këtu, blen një deputet, mund të blejë edhe dy, edhe tre), si do ta zgjidhim këtë situatë, e keni parashikuar? Do të kemi dy kryeministra? Dhe këtë situatë qesharake do ta ketë vetëm Shqipëria. E kemi virtuale, e di që s'ka për të ndodhur.

Unë po ju them edhe një gjë: kam qenë vazhdimisht i angazhuar në kohën që është bërë Kushtetuta dhe e di se sa nene janë bërë me qëllim që të mos na ndodhë ndonjë e

papritur, duke pasur parasysh Kryeministrin e sotëm Berisha. E zëmë se Berisha do të jetë President. Po sikur të mos e thërrasë Parlamentin e ri? Sepse ishte edhe ky rrezik. Atëherë është vënë që Parlamenti mund të mblidhet edhe vetë. Pra, kjo ka qenë, kjo është e vërteta dhe e kanë bërë miqtë e tu andej matanë. Por, unë po ju them, që në këto drafte, në këto amendamente, nuk lexoj vetëm zotin Berisha. Duket qartë që është dhe zoti Rama brenda. Jeni të dy bashkë.

Së dyti, do të them se në qoftë se do të shkruanim një gjë tjetër, në dyert e Parlamentit tonë, në këtë rast do të ishte: "Lufto për lirinë e të tjerëve!". E gjeni kund në këto amendamente lirinë e të tjerëve? Shikohet gjëkundi që këtu të zbulohet e vërteta e Gërdecit, për shembull? Dy grupet e mëdha parlamentare do t'i bënin nder vetes të uleshin, dhe unë jam shumë dakord që jeni në kohezion të plotë, dhe të zgjidhnin Gërdecin. Pastaj jepni pushtete! Sepse unë besoj që dikush nuk është i lirë nga krahu tjetër, kur Kryeministri ka thënë se të kam dhe ty ca letra. Jam shumë kurioz të di se si do të votojë ky person sonte, se ç'pushtete do të japë ai, nga ç'fuqi shpirtërore do të japë ai votën për këto amendamente.

Unë do të isha shumë dakord që të mblidhen të dy grupet tuaja parlamentare e të vendosin se ç'do të jetë Shqipëria në 15 vjet, se ç'do jetë rinia që sot është 10 vjeç, ose ata që janë nga 20 vjeç, ç'do jenë pas 10 vjetëve në këtë vend. Apo shpresoni që po të hyjmë në BE do të ikin të gjithë e të na lënë vetëm në këtu në Parlament. Nuk i lexoj gjëkundi këto preokupime në "kushtetuesen" tuaj. Nuk e shoh ku është rinia. Nuk e shoh ku janë pensionistët. Unë po ju them që nuk është ndonjë llogari e madhe dhe këtë e dinë farë mirë këtu, edhe ministri i Financave, në qoftë se do të jetë edhe ai prapë, që pas pesë ose dhjetë vjetëve do të kemi nja dyqind mijë njerëz pa pensione se nuk paguajnë sot sigurimet shoqërore.

Unë do të isha dakord me ju në qoftë se do ishte këtu reforma që duhet të bëjmë në arsim dhe në shëndetësi, qoftë edhe me një mbledhje të përbashkët të dy grupeve të mëdha parlamentare. Atëherë do të thosha me të vërtetë: këta burra kanë ardhur sot për të bërë një gjë të madhe për Shqipërinë. Do të isha sikur ju të bashkoheshit e të merrnit një vendim për pronën, të fiksonit përfundimisht se kujt i takon prona, ashtu siç e ka Kushtetuta. Akoma nuk keni zgjidhur detyrimin tuaj kushtetues për pronën. Lexojeni, e keni parë që nuk e keni zgjidhur akoma!

Kjo nuk është luftë për popullin, kjo është luftë për nja dhjetë vetë, që e lexojnë veten këtu dhe për nja njëzet të tjerë që kujtojnë se do të jenë numrat 1 dhe 2 të listave rajonale. Nuk kanë për të qenë. Këtë jua siguroj qind për qind.

Dhe e fundit që do të them: Dua t'ju pyes, kolegë, nëse me të vërtetë do të votoni ashtu siç keni hyrë, si ditën e parë kur keni bërë betimin në këtë sallë? Si opozitar i parë që kam hyrë në këtë sallë këtu e 18 vjet të shkuar, do të kërkoja të shkruhej edhe një gjë tjetër në dyert e këtij Parlamenti: "Ti që hyn këtu, dil njeri!"

Falemnderit!

**Jozefina Topalli** – Falemnderit, zoti Ceka!

Zoti Milo, 5 minuta.

**Paskal Milo** – E nderuara zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë e kam të vështirë sot në këtë seancë shumë të rëndësishme të Parlamentit tonë që të flas pa letër, ashtu siç folën kolegët e mi, jo se nuk jam në gjendje të flas pa letër, por në respekt të kësaj çështjeje madhore që jemi duke diskutuar, por dhe të vendimeve shumë të rëndësishme që do të marrim sot dhe që nuk kanë të bëjnë vetëm me të sotmen, por dhe me të ardhmen e demokracisë në Shqipëri, mendoj se kam reflektuar gjatë dhe jam përpjekur që disa mendime që kam dashur t'i shpreh këtu para jush t'i kem në letër. Më lejoni që t'i lexoj ashtu siç i kam shkruar.

Ndryshimet në Kushtetutën e Shqipërisë që janë sjellë për t'u diskutuar e miratuar në Kuvend janë të gabuara në metodën e përdorur, në synimet e përcaktuara dhe në mjetet e rrugët për të çuar në realizimin e tyre. Metoda është ajo e blic-krikut, e befasisë,

për të kapur e vënë përpara faktit të kryer segmentet më të ndërgjegjshme të politikës, të grupeve të interesit, të shoqërisë civile dhe të opinionit publik shqiptar.

Nuk është hera e parë që një metodë e tillë përdoret këtu në Kuvend. Ne jemi nga deputetët më të vjetër të kësaj salle. Është përdorur që nga dita e parë e seancës së parë parlamentare këtu, në prill të vitit 1992, pas zgjedhjeve të marsit, për ndryshimin e dispozitave kushtetuese, për t'i dhënë më shumë pushtete presidenciale kandidatit të atëhershëm dhe Kryeministrit të sotshëm, e deri në seancën e sotme që po ndodh e kundërta, që ish-Presidenti i djeshëm, i ngjeshur me pushtete ekzekutive, sot kërkon të zhveshë nga disa të drejta kushtetuese që janë prerogativa të rëndësishme për ekuilibrin e pushteteve, Presidentin aktual.

Me zotin Berisha ndodh, të më falë për krahasimin që po bëj, si me punën e breshkës, e cila kudo që vete e merr samarin me vete. Edhe ai kur ishte President mori shumë kompetenca ekzekutive dhe bënte edhe punën e Kryeministrit, si dhe shumë punë të tjera. Tani që është në detyrën e Kryeministrit nuk i mjaftojnë pushtetet që ka, por do të marrë dhe ca të tjera për t'u rehatuar në ambicien e tij të vjetër dhe të pandryshueshme të njeriut të gjithëpushtetshëm në Shqipëri.

Realizimi i këtyre synimeve të vjetra tani bëhet në rrethana të reja, shumë të favorshme. Në qoftë se në vitin 1992 ai u ndihmua nga një votë renegate socialdemokrate, këtu në rreshtin e katërt apo të pestë të qendrës, në referendumin e 4 nëntorit 1994 u pengua nga një opozitë e bashkuar, që, pak a shumë, është ajo që është sot. Ajo që ka ndryshuar tani në krahasim me vitet 1992 dhe 1994 nuk është pozita dhe synimet e zotit Berisha, për këtë bravo i qoftë për këmbënguljen që ka, por qëndrimet e një segmenti të opozitës së atëhershme dhe të sotme të Partisë Socialiste, që nga kundërshtuese e vendosur e tyre dikur, sot bëhet bashkëpunuese për realizimin e synimeve me zotin Sali Berisha.

Sigurisht që në këtë ndryshim të pozicionit të Partisë Socialiste mund të mos ketë interesa thjesht banale apo të kronikave të zeza mafioze, çka flitet poshtë e lart, por është jashtë çdo dyshimi që ka interesa dhe synime politike të çastit dhe të perspektivës, të veçanta dhe të përbashkëta me Partinë Demokratike dhe që, gjithashtu, nuk janë të panjohura. Gjoja në emër të reformimit të sistemit politik dhe të vendosjes së stabilitetit politik apo të zhdukjes së vulës së zezë të "Dushkut", siç tha dje zoti Kryeministër, të dy partitë kanë rënë dakord që të ndryshojnë disa nene të Kushtetutës.

Por për minutat e kufizuara që kam në dispozicion nuk e kam të mundur të sjell këtu të gjitha faktet dhe argumentet, por dua t'ju them se cilat janë këto synime.

Së pari, krijimi i një sistemi politik bipolar për alternimin e dy partive në pushtet dhe pengimin e garës së ndershme politike dhe elektorale, si dhe krijimin e një alternative tjetër politike konkurruese në të ardhmen.

Së dyti, prishja e parimit themelor të ekuilibrit të pushteteve në një republikë demokratike parlamentare. Dobësimi i institucioneve të përfaqësimit direkt të vullnetit të popullit, siç është Kuvendi, përmes shpërndarjes së tij në rast të një Kryeministri të dështuar. Zhvlerësimi i postit të Presidentit të Republikës si përfaqësues i popullit dhe shndërrimi i tij në një shtojcë të partisë politike që ka pushtetin e radhës. Marrja e shumë pushteteve nga ana e Kryeministrit, që e bën atë jo një shef ekzekutivi të një republike normale parlamentare, por një Kryeministër President të një republike *de facto* presidenciale, që do të jenë sipas radhë kryetarët e dy partive që do të alternohen me sistemin zgjedhor që propozohet.

Së treti, zhdukja ose atrofizimi i pluralizmit demokratik dhe hapja e rrugës që tendencat e njohura e të manifestuara paranojake në ushtrimin e funksioneve publike të zgjedhura ose të emëruara, të degjenerojnë e të përfundojnë në pushtete dhe institucione monokratike, diktatoriale.

Së katërti, krijimi i oborreve servile provinciale, partiake e parlamentare, që do të përsërisnin shumë herë më tepër e në mënyrë më frekvente, më keq se në kohën e komunizmit, çalltisjet frazeologjike me sloganin *trendy* të integritit në NATO dhe në Bashkimin Europian.



Atëherë, ka 18 vjet që Shqipërinë e kanë qeverisur këto dy parti, gati në mënyrë të barabartë, që nuk janë të njohura vetëm për meritat që kanë, por edhe për gabimet që kanë bërë. Atëherë, pse u duhet besuar sot e tutje këtyre dy partive për të sjellë në jetë ato premtime që nuk i realizuan për pak kohë. Madje, si mund të sinkronizohen këto dy parti në veprime të ndershme e në mirëbesim reciprok, kur ato nuk kanë lënë akuzë pa bërë për njëra-tjetrën dhe për liderët e tyre, deri në epitete nga më të rëndat dhe nga më skandalozet? Nuk i kemi thënë ne, ia kemi thënë njëri-tjetrit. Si mundet tani të gjenden së bashku në një front, në një unitet mendimi e veprimi, për të sjellë atë që nuk kanë bërë për 18 vjet?

Liderët e këtyre partive kanë përjasje të ndryshme në vlerësimin e qeverisjeve respektive të tyre në të kaluarën. Për njërin dielli ka shkëlqyer gjithnjë në vitet e qeverisjes së tij, ndërsa për tjetrin, gjatë qeverisjes socialiste, çdo gjë ka qenë e zezë, më e zezë se dhe vitet 1996-97, më e zezë se synimet e referendumit në vitin 1994 apo të ngjarjeve të 14 shtatorit 1998. Atëherë, si është e mundur që këto parti dhe liderët e tyre, që kanë përfaqësuar dy filozofi të kundërta politike qeverisëse, aq të dukshme e të njohura për shqiptarët, vjen një ditë dhe bashkohen, jo për aspiratat europiane të shqiptarëve, siç duan të justifikohen, por për reforma antidemokratike, në kundërshtim me standardet evropiane të kërkuara, jo për të zhdukur "Dushkun" e zi dhe të vjetër, por për të krijuar neo-"Dushkun" blozë e më të zi se ai i mëparshmi. Si është e mundur t'u ndërtojnë e t'u garantojnë shqiptarëve të ardhmen, kur ua kanë nxirë të kaluarën, jo të largët, dhe kur politika e Gërdecit e Qeverisë aktuale i riktheu në vëmendje të gjitha tmerret biblike të përjetuara në këta 17 vjetët e fundit.

Shqiptarët sot janë në një dilemë të madhe, përveç qarqeve të veçanta militante. Me siguri do të bëhen përpjekje që t'u ndalohet mundësia që të shprehen vetë në rrugë referendare për ndryshimet në ligjin kryesor të shtetit, pavarësisht se klauzolat ekzistojnë. Atëherë u takon deputetëve të ndërgjegjshëm dhe me integritet të këtij Kuvendi, atyre që vërtet janë kundër një shfaqjeje servile ndaj shefave të tyre politikë apo të një numri në listat e ardhshme të mbyllura për kandidat për deputet, të bëjnë aktin historik të kundërshtimit të këtij puçi kushtetues.

Falemnderit!

**Jozefina Topalli** – Falemnderit!

Zoti Lesi, urdhëroni!

**Nikollë Lesi** – Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zoti Kryeministër, Berisha,

Të qeverisësh do të thotë të bësh reformë dhe reformat nganjëherë janë të dhimbshme, qoftë për maxhorancën, qoftë për Kryeministrin që e drejton, qoftë edhe për shumicën e njerëzve. Por, me keqardhje, zoti Kryeministër, konstatoj se ju, personalisht, si asnjëherë tjetër në jetën tuaj politike, jeni peng, peng i disa kryetarëve, ministrave dhe deputetëve tuaj të maxhorancës, të cilët përfaqësojnë interesa jo të pastra politike dhe ligjore; jeni peng, zoti Kryeministër dhe e them me keqardhje si pjesëtar i kësaj maxhorance, megjithëse paketën që kanë sjellë sot Partia Socialiste dhe Partia Demokratike në parim e votoj, nenin 84/4 nuk do ta votoj.

I nderuar zoti Kryeministër, ju jeni nën presion. Nëse ju vazhdoni të jeni nën presionin e ministrave apo të ish-ministrave të Gërdecit, që të sollën Gërdec nëpër këmbë dhe në Qeveri, e ministrave që do të plasën "Gërdecë" të tjerë, të cilët, nëse do të ketë drejtësi të pavarur në këtë vend, do të përfundojnë në pranga, nuk besoj se do të votoj pro jush pas natës së sotme.

Zoti Kryeministër,

Kam qenë dhe mbetem një nga mbështetësit tuaj; ndonjëherë, jua kam thënë, jam mbështetësi juaj edhe me sy mbyllur, por kam përshtypjen se unë dhe disa deputetë të PD-së, duke qenë pjesëtarë të kësaj maxhorance, nganjëherë kemi bërë edhe gabime.

Ju në trupin e Partisë Demokratike po pranoni që disa kryetarë të partive të vogla dhe disa ministra të ngulin gozhdën e deputetit pas vitit 2009. Pikërisht këta ju bëjnë presion, i gjithë ky presion ishte edhe para një ore. Nuk ishte e moralshme që

Kryeministri të ngrihet, në faqe të të gjithë Parlamentit, e të shkojë në sallë nën presionin e disa kryetarëve të partive.

Ai kryetar partie apo ministër që nuk është dakord me këtë reformë, të dalë nga koalicioni, madje të dalë edhe nga Qeveria. Kryetar partie është ai që thotë: “Zoti Kryeministër, dal nga Qeveria dhe nga koalicioni i djathtë, sepse janë shkelur programi dhe parimet e partisë sime”. Por të gjithë, për të marrë xhaketën e deputetit në vitin 2009, kërkojnë të ngulin gozhdë në trupin e PD-së.

Zoti Kryeministër,

Nuk e dua atë gozhdë as në trupin tuaj, as në trupin e PD-së. Unë e siguroj vetë, por po ju them që nganjëherë në rrugën e gabuar shkoni nga presioni i një grupi mafiozësh; ju jeni nën presionin e disa ministrave që të sollën Gërdecin dhe ta lanë këtu, nëpër këmbë e ke ende.

I nderuar zoti Kryeministër,

Personalisht kam firmosur për nenin 87/4 të projektit që është sjellë. Megjithëse ju nuk keni qenë në sallë, e kam firmosur këtë nen me një kusht, ja ku e keni Astrit Patozin, ta mohojë ose ta pohojë një gjë të tillë, se është thënë me dy lista. Kam firmosur te lista e parë, me mirëbesim dhe me kusht që neni për Presidentin të ishte: Presidenti të votohet nga populli. Kryetari i Shtetit nuk mund të zgjidhet me votim të thjeshtë, zoti Kryeministër. Ju dhe një deputet i nderuar nga e majta në sallën e Kuvendit, kur diskutohej kandidatura e Bamir Topit dhe e disa të tjerëve, keni thënë që Presidentin ne do ta zgjedhim nga populli. Populli është autoriteti dhe numri një i shtetit. Këtë bindje keni pasur, këtë bindje besoj se do ta kesh, dhe këtë nen, me keqardhje të madhe, nuk e votoj. Nuk mund të votohet Presidenti i Republikës si një anëtar bordi me votim të thjeshtë.

Zonja Kryetare,

Ne deputetët që jemi të pavarur dhe të përjashtuar nga partia, që na solli në Parlament, kemi edhe disa minuta shtesë me mik.

Zoti Kryeministër,

Ja ku e keni Pashk Ujkën, kryetarin e grupit demokristian, ja ku e keni Tom Doshin, ja ku i keni edhe dy zëvendësministrat tuaj, Gurakuqin e zotin Bushati dhe plot demokristianë që ju kanë sjellë 55 mijë vota më 3 korrik dhe të dhanë edhe votën në maxhorancë, i keni pro teje në reforma, por mos rrini nën presion. Po qëndrove nën presion, nën pazare, i bie të dorëzohesh vetë dhe në anijen tënde që e kam thënë në Parlament, e kemi thënë më 3 korrik në Sarandë, kur së bashku ishim përballë ish-Kryeministrit Nano, e mbani mend...

**Jozefina Topalli** – (*E ndërpret.*) Zoti Lesi, ka mbaruar koha.

**Nikollë Lesi** – (*Vazhdon.*) Zonja Kryetare, ju lutem, të mos prishim seancën, se ju e dini që shquhem për prishje seance, prandaj ma lini ta mbaroj diskutimin tim.

Kemi thënë, zoti Kryeministër, që anija e Nanos po fut ujë, se kapiteni nuk ishte në rregull. Ti je kapiteni i një anijeje që anëtarët e ekuipazhit po të shpojnë anijen e do ta mbysin. Vetë ata do të ikin me gomone dhe me anije të tjera. Prandaj largoji nga anija juaj!

Falemnderit!

**Jozefina Topalli** – Falemnderit!

Fjalën e ka zoti Meta.

**Ilir Meta** – Zonja Kryetare,

Nuk do t’ju marr shumë kohë, sepse sot nuk duhen shumë argumente, pasi gjithçka është e paravendosur në mënyrën më antidemokratike dhe më të turpshme, sepse bëhet fjalë për të ndryshuar në thelb Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kushtetutë kjo e votuar me referendum nga populli shqiptar.

Pikërisht sot Sali Berisha merr të gjitha ato që kërkoi nga populli shqiptar 14 vjet më parë në referendumin kur ai hodhi projektkushtetutën e tij, pra arrin sot të gjitha pushtetet që donte atëherë, por këtë po e arrin pa referendum; po e arrin këtë këtu në Parlament, i merr të gjitha në një tavolinë ku është diskutuar dhe ne nuk kemi qenë,

pikërisht nga Kryetari aktual i Partisë Socialiste, Edi Rama. Janë ndryshime që në thelb dhe në zemër godasin Kushtetutën dhe parlamentarizmin në Shqipëri; janë ndryshime që godasin në zemër pluralizmin politik në vend.

Pas këtyre ndryshimeve kushtetuese, Shqipëria nuk mund të jetë më republikë parlamentare. Ajo mund të quhet një republikë berishiane, sepse ndryshimet që bëhen sot në Kushtetutë, bëhen në funksion të forcimit të jashtëzakonshëm të pozitive të Kryeministrit dhe në kurriz të parlamentarizmit, në kurriz të të gjitha institucioneve kushtetuese që janë garante për të drejtat themelore të qytetarëve të këtij vendi.

Sot, përmes zhvlerësimit që i bëhet institucionit të Presidentit, i cili, tashmë, mund të zgjidhet ose mund të ndërrohet, sikurse ndodh rëndom me anëtarë bordesh, që i përmendi një parafolës apo me një ministër të thjeshtë, në fakt, kemi goditjen më të madhe që u jepet gjithë institucioneve kushtetuese në vend, që janë garante për mbrojtjen e të drejtave themelore të çdo qytetari shqiptar, sepse pozicioni mbipartiak i deritanishëm i Presidentit, për shkak të mënyrës së zgjedhjes së caktuar në Kushtetutën e deritanishme, ka qenë garancia për mbrojtjen e pavarësisë së institucioneve në këtë vend.

Ku shkuan premtimet e drejtuesve të dy partive të vjetra përpara se të uleshin në tryezën për zgjedhjen e Presidentit, kur shpreheshin se e mira është që Presidenti të zgjidhet nga populli, por, meqenëse ne nuk kemi kohë, atëherë këtë herë do bëjmë si do bëjmë, e do ta zgjedhim në tavolinë, por herën tjetër do ta zgjedhim në popull? Përse i shmangen këtij premtimi dhe këtij angazhimi? Përgjigjja është e thjeshtë: ndryshimet kushtetuese, që e kthejnë Republikën e Shqipërisë në republikë berishiane, sepse Berisha është sot Kryeministër dhe nuk është President si në vitin 1994, forcojnë në mënyrë të jashtëzakonshme karakterin partiak të shtetit dhe godasin në zemër karakterin demokratik të shtetit të së drejtës. Mburren me të madhe se do të bëjnë një reformë të hatashme zgjedhore për të eliminuar “Dushkun”. Këtë e thonë pikërisht ata që pollën “Dushkun”, duke shkelur Kushtetutën; ata që po bëjnë këto ndryshime duke blerë 30 deputetët e “Dushkut”, që janë këtu sot në Parlament. Më këta po ndryshohet Kushtetuta dhe po hidhet poshtë vullneti i një populli të tërë i shprehur përpara 9 vjetësh.

Nuk jemi kundër proporcionalit rajonal, meqenëse e kërkon; nuk kemi qenë as kundër maxhoritarit, meqenëse keni hallin e maxhorancave të fuqishme, sepse edhe maxhoritari i pastër është një sistem i ndershëm, por sistemi që ju propozoni është një sistem hileqar, i pandershëm, sepse ai përsëri do të pjellë deformime të votës së shqiptarëve, do të godasë barazinë e votës, që është një element thelbësor edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Ne do të votonim sistemin proporcional rajonal, në rast se Shqipëria do të ndahej në rajone zgjedhore me numër të barabartë zgjedhësish dhe do të kishte, pak a shumë, të njëjtin prag; ose nëse do të kishte një korrektim nacional, përndryshe sistemi që ju sillni është një deformim, është një tjetër mashtrim për opinionin publik. Jo vetëm kaq, por me këtë sistem dhe me turpin e madh që keni bërë, që keni vendosur edhe në Kushtetutë sesi do të jenë listat e deputetëve të renditura dhe nuk mund të ndryshohet renditja e përcaktuar nga kryetarët e partive, ju keni treguar moralin e vërtetë që i trembeni ballafaqimit me qytetarët shqiptarë; moralin e vërtetë që deputetët nuk duhet të sjellin më shqetësimet dhe problemet e komunitetit, por duhet të jenë ushtarë të kryetarëve të partive.

Ju, njëkohësisht, me këtë veprim që po bëni sot, me mënyrën më të pandershme, me një mënyrë jo transparente po tregoni që po bëheni viktimat të një afere shumë të madhe dhe të fëlliqur, shumë antishqiptare midis Sali Berishës dhe Edi Ramës; po merrni përgjegjësinë për një Kushtetutë, që, në rast se do të miratohet nga ju, sot do të quhet Kushtetuta e Sali Ramës ose ndryshe Kushtetuta e Gërdecit, ku gjenden peng që të dy, tashmë.

**Jozefina Topalli – Falemnderit!**

Zoti Koçi, urdhëroni!

**Petro Koçi** – Të nderuar kolegë,

E ritheksoj që sot është një seancë funerali për demokracinë dhe për Kushtetutën. Në fakt, ky projekt që na ka ardhur sot në Kuvend nuk është aspak serioz.

Është hera e parë që ndryshimet e Kushtetutës vijnë si një pazar interesash; është një moment kur ne ndryshojmë kartën themelore të shtetit në kundërshtim me mësimet që ka nxjerrë politika shqiptare jo vetëm e 18 vjetëve të fundit, por edhe më parë.

Ne kemi menduar se demokracia parlamentare duhet të vijë drejt përmirësimit, ndoshta do të duhej që edhe kjo kartë themelore e shtetit të ndryshojë, por duhet të ndryshojë duke rritur parametrat e një demokracie parlamentare.

Në fakt, projekti që ka ardhur sot nga Qeveria apo nga bashkëqeverisja, synon kthimin e demokracisë parlamentare në një republikë kryeministrale. A s'më thoni: a nuk kemi vuajtur ne gjithmonë nga pushtetet e njëshit, jo vetëm gjatë 50 vjetëve të Enver Hoxhës, por edhe më parë, edhe në kohën e Zogut, por edhe në kohën e Saliut të parë? Më thoni: A nuk është ky projekt në kundërshtim me vuajtjet politike të shqiptarëve në dhjetëra vite? Sigurisht që po.

Ky është një projekt që synon privatizimin total të politikës. Më në fund edhe qeveritë, edhe listat e deputetëve do të jenë plotësisht private, ndryshe nga deri tani ku diçka edhe ka funksionuar, ka pasur pak balancë midis pushteteve të kryetarëve dhe kërkesave për aspirata të komuniteteve zgjedhore në bazë. A nuk duket sikur "Dushkun" e mëparshëm po e shndërrojmë në një "Dushk" të ri, sepse ky është një sistem që do të eliminojë çdo votim ndryshe? Unë jam dakord që Shqipëria kishte nevojë për rritjen e pragut elektoral, pra të mos mbetej 2,5%, le të shkonte edhe 5%, që të kishim më pak partiçka në Parlament. Por me këtë variant të Qeverisë ose të bashkëqeverisjes, sigurisht që synohet të eliminohet çdo votim ndryshe. Ky projekt është një urrejtje ndaj mendimit dhe votimit ndryshe. Kodi që synohet të përjetësohet në këtë ndryshim kushtetues nuk është një garanci për qytetarët që zgjedhin, është një garanci, sidomos, për nomenklaturat e vjetra, të cilat po shfaqen me sloganin e politikës së re. Po vijnë në politikën e re ata që në vitet '91-'92 u futën vrimave, sepse nuk kishin kurajë të dilnin në sheshin publik të politikës. Prandaj ky projekt duhet votuar kundër.

Së fundi, mua më vjen keq për disa nga kolegët e mi. Në fakt, i gjithë projekti që ka ardhur bie ndesh me të gjitha mësimet dhe pësimet e politikës në 18 vjet edhe për kolegët e mi, por një pjesë prej tyre i ka gjetur si te filmi "Operacioni i zjarrit", që ndoshta shpresoj se e keni parë të gjithë. Në fund të filmit është një personazh dytësor, i cili thotë "Për një viç më zu nata jashtë". Edhe këtu për një vend në listë, disa i ka zënë nata jashtë.

Dua t'ju kujtoj edhe një përcaktim që Cvajgu u ka bërë intelektualëve: "Janë dy lloj intelektualësh, janë atë që ulërasin kur e ndiejnë rrezikun, dhe paralajmërojnë me ulërimën e tyre, dhe janë ata që ulërasin kur e pësojnë". Këtu një pjesë e mirë e deputetëve janë autorë të këtij krimi kushtetues; nesër do të jenë viktima të tij.

Falemnderit!

**Jozefina Topalli** – Urdhëroni, zoti Ujka!

**Pashko Ujka** – E nderuara zonja Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Problemi që unë dua të diskutoj vërtitet rreth sistemit proporcional rajonal, i cili është propozuar nga të dyja partitë e mëdha. Them se ky është një sistem, i cili ne partive të vogla nuk duhet të na bëjë pesimistë dhe nuk duhet të na krijojë probleme. Meqenëse nëpër podiumet tona vazhdimisht është dëgjuar forca jonë, mundësia jonë, elektorati ynë, i cili është shumë i madh, atëherë them se edhe ky sistem do të na japë mundësi më të mëdha që ta demonstrojmë këtë forcë dhe ta tregojmë me votat që do të vijmë në Parlament.

Një problem tjetër është se Partia Demokratike dhe ajo Socialiste, besoj se është nga herët e rralla që dy partitë e mëdha, që përfaqësojnë rreth 90% të elektoratit shqiptar po rrinë e po na dëgjojnë ne partitë të vogla që po bëjmë spektakël. Kjo përqindje e votave që kanë partitë e vogla te shqiptarët dihet nga të gjithë. Këtu ka dy probleme: ose

ju na keni krijuar terren e mundësi shumë të mëdha dhe kemi ngrënë shumë në kurrizin tuaj, e për këtë fajin e keni ju, ose ne duhet të mblidhemi, të diskutojmë dhe të hyjmë në zgjedhjet e ardhshme parlamentare me mendje të fjetur se votat që ne meritojmë populli do të na i japë.

Tani në qoftë se është e para, Partia Demokratike në pushtet, Partia Socialiste në minorancë i kanë parë të dyja, në momentet kur kanë qeverisur, sesa probleme janë krijuar nga partitë e vogla. Ne na është rritur shumë mendja dhe këtë defekt e keni ju. Ju edhe tani po e shihni se po na dëgjoni vetëm ne, po dëgjoni kryetarë partish me një deputet, po dëgjoni forca politike me pak forca, po dëgjoni elektorat pa elektorat. Ju na keni dhënë votat, na keni sjellë në Parlament, na keni ndihmuar. Ka pasë thënë një fjalë e urtë popullore: "Rrit këlyshë se të hanë qentë!".

Për sa i takon sistemit them se pak a shumë ky është i qartë dhe njerëzit e presin. Ju drejtohem kolegëve, njerëzve, shokëve dhe miqve, a i kemi ne si maxhorancë votat për të qeverisur Shqipërinë në këtë formë që qeveriset? A i kemi ne si parti aleate të PD-së mundësitë, eksperiencën, njerëzit, kontributet që të marrim rreth 60%-70% të administratës publike në shkallë republike? Këtë e di PD-ja. Kohët e fundit kanë dalë fjalë, që bëj presion se diçka merr. Këto fjalë Berisha, ai iku, por mirë është t'i dëgjojë, se po të vazhdohet me këtë presion, më mirë të shkojmë në zgjedhje të parakohshme.

Përveç sistemit proporcional rajonal që diskutohet, që unë e kam mbështetur si deputet, ka edhe probleme, të cilat duhet të diskutohen dhe nuk e kuptoj se pse hyn versioni i Presidentit. A nuk ishte kjo sallë parlamentare që e çoi zotin Topi President? A votuam ne për zotin Topi President? Për çfarë arsye sillet tani kështu zoti Topi, kur e ka edhe katër vjet mandatin? Në mos PD-ja, PS-ja do të zgjedhë Presidentin, se ne partive të vogla nuk ma merr mendja të na jepet rasti të zgjedhim Presidentin. Ku qëndron kjo, nuk e kuptoj? Megjithatë, unë dua ta anashkaloj këtë pikë. Ata që e kanë servitur në tavolinë, ata të japin përgjigje.

Për sa i takon KQZ-së, për ne të gjithë këtu ka qenë pengesë. Madje, shumë deputetë janë bërë që të paguajnë ryshfete për të dalë mbi veten. Shyqyr që erdhi koha dhe këtu nuk dëgjohet asnjë fjalë. I ka kapur kriza elektorale e vitit 2009. Harrohet se këtu ka detyrime para këtij populli, se ka edhe një vit e gjysmë kohë për reforma, ka shumë probleme, shumë halle dhe telashe ky popull. Unë, pa dashur të anashkaloj edhe mendimet e grupit tim parlamentar dhe të shokëve me të cilët bashkëjetoj, them që ne duhet të mblidhemi, ta analizojmë çështjen me gjakftohtësi dhe të japim një përgjigje sa më të qetë që njerëzit të na kuptojnë se për çfarë arsye po kërkohet të ndërhyhet në Kushtetutë. Kushtetuta është një marrëveshje mes palëve, e cila duhet të jetë sa më dinjitoze, sa më e mundshme për të realizuar aspiratat e këtij populli. Në qoftë se ne si parlamentarë populli na ka sjellë këtu për të drejtuar dhe nuk drejtohet në mënyrë institucionale e kushtetuese, atëherë, kjo Kushtetutë duhet të ndryshojë, se i ka ikur koha.

Problemi i fundit është problemi i diskutimit për partitë e vogla, ku unë bëj pjesë. Unë them që në qoftë se ne do të angazhohemi të bëjmë aleanca parazgjedhore, edhe paszgjedhore, kush është më i fuqishëm do të arrijë që të vijë përsëri në Parlament, do të arrijë përsëri të përfaqësojë elektoratin dhe njerëzit. Njerëzit të kenë besim se nuk është kështu siç flitet, por PD-ja dhe PS-ja, meqenëse vetë i kanë ngritur këto parti të vogla dhe vetë na kanë sjellë deri këtu, të mendojnë edhe pak për ne, meqenëse ndoshta nuk ka ardhur koha për të ikur totalisht.

Falemnderit!

**Jozefina Topalli** – Falemnderit, zoti Ujka!

Fjalën e ka zoti Bejtaj, pesë minuta.

**Engjell Bejtaj** – Zonja Kryetare,

Në radhë të parë, nuk e kuptoj dot procedurën që ndiqni në përcaktimin e kohës. Në asnjë nen të Rregullores nuk thuhet që ju mund t'u caktoni deputetëve kohën e diskutimit; ajo është e përcaktuar në një mënyrë tjetër. Por le të shpresojmë se çka kam për të thënë, ta them edhe në ato pesë minuta që më dhatë.

E ndiej për detyrë morale të diskutoj këtu, me statusin e ish-anëtarit të komisionit që e hartoi Kushtetutën, që sot po mundohet të hidhet në erë. Me vjen mirë që këtu ka edhe ndonjë tjetër, respektoj avokat Ngjelën për kontributin që ka dhënë në vitin '98 për hartimin e Kushtetutës dhe për diskutimin e sotëm. Por ajo që bie në sy është se brenda harkut të 10 vjetëve Shqipëria në vend që të ecë përpara në drejtim të standardeve demokratike, ka bërë mbrapa. Nëse do t'i kthehemi mënyrës sesi u hartua ajo Kushtetutë, procedurave, në të cilat ajo kaloi, diskutimeve në të gjitha instancat, në të gjitha strukturat me grupe interesi, specialistë, ekspertë, patjetër që ajo mënyrë është e pakrahasueshme me këtë të sotmen. Shumëkush e ka besuar këtu në Parlament që do të vinte një ditë që do të ndryshohej Kushtetuta për shkak të ndryshimeve që ka pësuar vendi. Por, lehtësia me të cilën po ndryshohet ka të bëjë me faktin që ajo është shkelur pafundësisht. Them pafundësisht, pasi, nëse shkelet më shumë se një herë nuk ka më rëndësi. Kushtetuta është themeli i shtetit, të cilin nuk duhet shkuar ndër mend ta shkelësh, pa le për ta bërë atë. Ky Parlament me votat e tij ka miratuar jo më pak se 15 ligje që bien ndesh me Kushtetutën. Pra, këto janë shkelje të Kushtetutës. Nxitimi me anë të të cilit po bëhen përpjekje për ndryshime është i pashpjegueshëm në momente të caktuara, por, po t'i hysh thellë, kuptohet. Nëse në momentin e parë duket i pashpjegueshëm, atëherë ne mund të themi që Shqipëria nuk ka më asnjë urgjencë. Nëse këto ndryshime duheshin bërë që në të pranoheshim, të merrnim ftesën për në NATO, atë tashmë e morëm. Ajo çka dua të them është që marrja e ftesës për në NATO, ju jep kurajën që ta ndryshoni këtë Kushtetutë, se, me sa duket, nuk ka më se kush ju kritikon ose me sa duket nuk ka më vlerë nëse e bëni këtë.

Dikush mund të thotë që ndryshimet në Kushtetutë janë të pastudiuara. Kjo është e vërtetë; për ta përmirësuar atë, janë të pastudiuara, sepse nuk ka asnjë relacion, asnjë studim të mirëfilltë për të thënë se ku janë ngërçet. Kjo Kushtetutë që kemi ka disa ngërçe, por ato në asnjë rast nuk kanë dhënë efekte të drejtpërdrejta. Një nga ngërçet është zgjedhja e Presidentit. Por si mund të themi që është ngërç, kur në të dyja rastet që është dashur të zgjidhet Presidenti me këtë Kushtetutë, është realizuar? Atëherë, ky nuk është ngërç. Mund të jetë ngërç vetë Presidenti.

Gjithashtu, do të thosha që ato janë të pastudiuara për ta përmirësuar Kushtetutën, por janë shumë të studiuara për ta prishur atë. Si është e mundur që dy atentate, që janë bërë në këtë drejtim, janë një i vitit 1994, i cili tentoi të krijonte pushtete ose një President të gjithëfuqishëm; sot, gjithashtu, është atentati tjetër, që tentohet të krijohet një Kryeministër i gjithëfuqishëm. Pika e bashkimit midis '94 dhe 2008 është Sali Berisha, ish-President dhe tani Kryeministër.

Atëherë, çfarë duhet të bëjmë? Është e vërtetë që ne këtu vetëm mund të flasim dhe mund të votojmë, por gjithsesi në ndërgjegjen e kujtdo prej deputetëve, përpara se të votojë do të duhet të kalojë edhe një herë ndër mend detyrimi që ka për t'i dhënë standard demokratik këtij vendi, dhe jo për t'ia reduktuar atë.

Personalisht, po e them që do ta votoj kundër, për faktin se kjo Kushtetutë, ky projekt, këto ndryshime nuk meritojnë ndryshe. E kam provuar edhe një herë ta votoj kundër një ndryshim, është ai i bërë para më shumë se një viti. Jam i bindur që edhe sot, nëse do të silleshin ato ndryshime, përsëri do të votoja kundër. Nuk kam asnjë objeksion, nuk kam pasur asnjë qëllim të veçantë, përveç faktit që isha i bindur që ai ndryshim e përkeqësoi Kushtetutën. Edhe sot jam i bindur që këto ndryshime nuk po e përkeqësojnë, por këto po e eliminojnë Kushtetutën. Atëherë edhe një herë i bëj thirrje ndërgjegjes të deputetëve që ta kenë në konsideratë këtë.

*(Zoti Beja ka marrë drejtimin e seancës.)*

**Fatos Beja** – Falemnderit!

Fjalën e ka zoti Braho.

**Spartak Braho** – Duke shfrytëzuar daljen këtu, zoti drejtues i seancës, unë edhe një herë dua të ngre një çështje të procedurës.

Ju lutem shumë, ende nuk keni dhënë përgjigje se ku janë amendamentet e 35 deputetëve! Na jepni përgjigje se ku janë amendamentet e 35 deputetëve! Do të futen sot

për shqyrtim apo jo? Kjo pyetje, ndoshta nuk ju takon ju, i takon asaj zonjës ose këtij zotërisë që ishte këtu. Na jepni përgjigje se ku janë, sepse siç e shikoni, këtu ka mbetur vetëm zoti Pandi, këta të tjerët kanë ulur kokat se kanë turp, sepse kanë bredhur me ne për të miratuar këtë Kushtetutë, po sot nuk flasin. Edhe këta të tjerët kështu kanë bërë. Prandaj, na thoni këto amendamente të 35 deputetëve, zonja Kryetare, do të futen në seancë apo jo?

Ku janë amendamentet? Na thoni, ku janë ekspertët kushtetues? Në Komisionin e Reformës Zgjedhore erdhi Genc Ibrahimi, erdhi Vangjel Kosta, erdhi Luan Omari. Ku janë ekspertët? Pse me këto zonja të nderuara do t'i mbroni? Ato janë shumë të nderuara, po ku janë ekspertët, ku janë konstitucionalistët? Kjo është qesharake!

Kush do të përgjigjet për këto pyetje? Të dy relatorët kanë ikur, sepse njërin e thirri kryetari i partisë, tjetri nuk është këtu.

Të lutem, zonja Kryetare, më jep një përgjigje. Unë nuk do të iki nga podiumi në qoftë se ju nuk më jepni përgjigje. Ku janë amendamentet e propozuara nga 35 deputetët? Do të futen për votim?

Atëherë, po filloj diskutimin.

Të nderuar kolegë,

Kjo seancë për nga rëndësia dhe shija e hidhur që do të lërë për shumë kohë do të na kujtojë trishtimin e pasojës së tragjedisë së Gërdecit, pasi një Gërdec kushtetues do të synojë të copëtojë Kushtetutën e Shqipërisë, e konsideruar 10 vjet më parë si një ngjarje historike, që hodhi themelet e ndërtimit të strukturave të një shteti demokratik, por që Sali Rexhepët e rinj po e hedhin në erë.

Po ashtu ne jemi dëshmitarë okularë, se fitilin zjarrvënës këtij dokumenti themelor po ia vë Sali Berisha dhe pasuesit e tij, por gjasme dhe opozita, PS-ja e sotme, lideri kryesor i së cilës jo më larg se një vit na paraqitej krejtësisht ndryshe për reformën zgjedhore, por edhe për zgjedhjen e Presidentit nga populli. Ky është një qëndrim jo vetëm antikombëtar, por edhe kriminal me antivlerat politike dhe institucionale që realizon.

Sinkronizimi i ideve, i programeve dhe qëllimeve të PS-së dhe PD-së, dhe direkt Berisha-Rama, tashmë, ka harruar regjimin e korrumpuar të qeverisjes Berisha, që duhet të largohet, citoj Edi Ramën. Ky sinkron harroi Gërdecin dhe dhjetëra të vrarë e qindra të plagosur e të dëmtuar, harroi përgjegjësinë e shkaktarët kryesorë, harroi Gazideden dhe Remzi Hoxhën apo "Dosjen 449", që e ka sigluar për ta zhdukur nga faqja e dheut, harroi komisionet hetimore të ngritura me aq bujë për të hetuar bëmat e kësaj opozite, harroi aferat e rrugës Durrës-Kukës dhe ministrin përkatës. Madje Edi Rama ka harruar dhe një padi penale që ka ngritur kundër këtij të fundit, sepse tani janë bërë ortakë. Duke shpartalluar instrumentet parlamentare, komisionin e posaçëm të ngritur, të dyja partitë dhe përfaqësuesit e tyre e kthyen tërë procesin e reformave kushtetuese në një teatër marionetash dhe në një karagjozllëk firmash e relacionesh, që shoqëruan këto amendamente të sotme.

Ku janë dhe pse kjo dyshe organizoi dhe përzuri nga oponenca ekspertët konstitucionalistë, të cilët i përmenda më sipër? Me çfarë mendimi të kualifikuar u zëvendësuan ata, vetëm me injorancën dhe etjen skurpuloze të jesmenëve e të disa përfaqësuesve reciprokë pseudojuristë?

Amendamentet e reformës zgjedhore nuk janë gjë tjetër vetëm produkt, se zgjedhjet e vitit 2009 do të jenë më të këqijat e këtyre dy dekadave, se do të kantonizojnë e copëtojnë vendin e do të shtrembërojnë parametrat e pluralizmit politik e të demokracisë, se votat do të trajtohen përsëri në formën e një neo "Dushku" dhe vlera e saj do të shtrembërohet.

Lexoni me kujdes, të nderuar kolegë, amendamentet kushtetuese të propozuara. Ato jo vetëm në përmbajtje, por edhe në formë janë më të dobëta se një rregullore. Është më se e shpjegueshme se formulimin e nxituar të tyre e mbizotëron amatorizmi dhe klientelizmi. Madje kaq e thellë është kjo sa kanë lënë pa shoqëruar amendamentet e tyre dhe me dispozita kalimtare për kohën e veprimtimit të tyre, gjë që i bën ato nul.

Të nderuar kolegë,

Unë ju drejtohem juve që as majtas dhe as djathtas, por majtas e djathtas, të mos i votoni këto propozime për shumë arsye, po në thelb vetëm për njërin. Mos i ktheni shqiptarët mbrapa në vitin '94, në riciklimin e neodiktaturës bipartizane Rama-Berisha.

**Jozefina Topalli** – Atëherë, në emër të Grupit Parlamentar të PSD-së, zoti Gjinushi, urdhëroni!

Do flisni pak më vonë? Mirë, si të dëshironi.

Zoti Xhufi, urdhëroni!

**Pëllumb Xhufi** –Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot ky Kuvend është mbledhur me nxitim për të shkruar një nga faqet më të turpshme të historisë së vet. Nëpërmjet ndryshimeve kushtetuese, sot kërkohet të hidhen bazat e një dypushteti, i cili, gjithsesi, nuk mund të qëndrojë i tillë. Në Romën e vjetër, të nderuar kolegë deputetë, ka pasur një moment kur pushteti u ushtrua, njëkohësisht, nga dy burra, ndaj dhe u quajt periudha e Dumviratit. Por kjo ishte një periudhë e shkurtër e tranzitore që më në fund çoi në pushtetin e vetëm të një burri, në atë që historia romake e quan diktatura e Silës, disa të tjerë e quajnë diktatura e Sulës dhe po të na rrëshqiste goja, ne do ta quanim gabimisht diktatura e Salës, sepse histori, të nderuar kolegë, me burra të tillë përfundojnë gjithnjë në të njëjtin stacion, në diktaturë.

Shikoni, historia përsëritet, jo vetëm ky Sila, Sula, Sala për të cilin fola, por edhe Musolini, edhe Hitleri në Gjermani, erdhën në pushtet, ashtu siç kërkojnë të bëjnë edhe këta të dy dumvirët tanë, duke pretenduar se duan të revolucionarizojnë sistemin në emër të stabilitetit politik. Kush na e ka cenuar stabilitetin politik në këta 17 vjet të demokracisë? Partitë e vogla virtuale, thotë një reformator i vogël i majtë, roli i të cilit në partinë e vet maksimizohet pikërisht në kohë intrigash e pislëqesh. Kush tjetër e cenon stabilitetin politik në vend? Presidenti, thotë një ish-President i dështuar e mëkatar, i cili gati sa nuk propozon që Presidenti të jetë anëtar i rregullt partie, të bëjë pjesë në një organizatë bazë dhe të paguajë kuotat, sipas parimit leninist. E pra, ne themi se destabilitetin politik në Shqipëri nuk e kanë sjellë partitë e vogla, që në të kundërtën kanë qenë mekanizma të domosdoshëm balancimi. Destabilitetin politik në Shqipëri e kanë sjellë partitë e mëdha, e kanë sjellë liderët autoritaristë e autokratë të tyre. Destabilitetin politik nuk e kanë sjellë presidentët e “pasdemokracisë berishiane”, që përkundrazi kanë qenë pikë e besueshme referimi për shqiptarët e për partnerët e huaj në krizat e provokuara pikërisht nga liderët e partive, që herë pas here u ikën fiqiri.

Ndryshimet kushtetuese që na janë vënë përpara nuk janë produkt i një debati politik, por janë produkt i një dialogu të pamoralshëm, përjashtues e pa transparencë të bërë në skutat e malapolitikës nga dyshja, domethënë, nga Dumvirati i përkohshëm PD-PS, ose më saktë Rama –Berisha. Duke qenë të tilla, këto ndryshime, më së pakti, nuk janë serioze.

Më thoni, të nderuar kolegë, ku qëndron serioziteti në propozimin për ngushtimin e kompetencave të Presidentit? A mos vallë në fytyrën habitore të zëdhënësve të PD-së, që për disa herë brenda një jave i anonçuan ndryshimet përkatëse, për t'i tërhequr sa hap e mbyll sytë, për t'i rilançuar dhe për t'i tërhequr prapë, e prapë, e prapë? A mos ishte serioze të shikoje garën e të zellshmëve të Partisë Socialiste, që mbështetën symbyllur ndryshimet e Berishës e pastaj plot 24 orë, pasi vetë Berisha hoqi dorë nga varianti apo më saktë nga grushti i mizave që hodhi, këta dalin si kokoroshë e deklarojnë se Berisha duhet ta harrojë ngushtimin e kompetencave të Presidentit, se përndryshe duhet të kalojë mbi trupat e tyre.

Ne kemi deklaruar dhe deklarojmë se modeli zgjedhor që ju keni zgjedhur për të gatuar Dumviratin tuaj është një model antikombëtar. Ai synon që nëpërmjet zgjedhjeve dhe proceseve politiko-institucionale, që janë të lidhura me zgjedhjet, ta kantonizojë Shqipërinë. Ju nuk jeni mjaftuar të fiksoni në Kushtetutë sistemin proporcional. Ju këmbëngulët të fiksoni aty edhe modelin spanjoll për t'ua lënë peshqesh atë zgjedhjeve



të ardhshme. Modeli spanjoll, sigurisht, është demokratik në Spanjë, por nuk është e thënë të jetë aq demokratik në Shqipëri. Dikur, një koleg i nderuar, zoti Gjinushi ka thënë: droga, hashishi është i legalizuar, i ligjshëm në Holandë, por nuk ka pse të jetë i legalizuar në Shqipëri apo në Europë. Kjo natyrisht, zonja ministre, (që nuk qenka në sallë) besoj se nuk përbën një standard për Marrëveshjen e Asociim-Stabilizimit. Modeli proporcional rajonal është i papërshtatshëm për Shqipërinë e vogël, sepse presupozon ndarje të thella mes krahinave të vendit, që kurrsesi nuk ekzistojnë, sepse lejon pabarazinë e votës, moslogaritjen e votës dhe orientimin e votës. Me një fjalë, është një model që mundëson deformimin e votës dhe të rezultatit elektoral jo më pak se "Dushku" i shpikur po nga protagonistët e kësaj reforme elektorale.

Së fundi, nuk mund të mos lëmë pa përmendur që kjo reformë dyshe është mbarsur në kohë të keqe, në kohën kur shpërthimi tragjik i Gërdecit nxori në pah qelbin e korrupsionit, që ka pushtuar Qeverinë "Berisha" dhe segmente të tjera të politikës. Derisa kjo politikë të pastrohet nga qelbi i korrupsionit, çdo vendim, çdo ligj, çdo reformë nuk do të mund të prodhojë tjetër veçse aborte politike.

Falemnderit!

**Jozefina Topalli** – Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Reformator, zoti Shehu, urdhëroni!

**Tritan Shehu** – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Jemi, pa dyshim, përpara një vendimi të rëndësishëm që janë ndryshimet kushtetuese, një vendim, i cili merret me përgjegjësi nga të gjithë ne, një vendim për të cilin, realisht, unë mendoj që të gjithë ne bashkë, gjithsekush nga ne, ka kristalizuar mendimet e tij, mendime, të cilat nuk mund të lihen për t'u improvizuar në sekondën e fundit.

Pa dyshim, është një ndryshim i ligjit themeltar, i cili ngjall debate, i cili lidhet me ndryshimin e sistemit zgjedhor apo me implementimin e sistemit zgjedhor në vendin tonë, me ndryshime të tjera kushtetuese, të cilat përfaqësojnë mendime të ndryshme, por që lidhen edhe me interesa të ndryshme. Pra është i justifikueshëm debati, diskutimi, është i justifikueshëm, gjithashtu, edhe dialogu midis forcave politike, i cili, fatmirësisht, ka filluar të lindë në vendin tonë, pikërisht për këto elemente të rëndësishme të jetës politike të vendit.

Unë mund të them se është i pajustificueshëm përdorimi i epiteteve, akuzave, krijimi i situatave, të cilat realisht nuk përputhen me realitetin, nuk përputhen me atë për të cilën ne po kërkojmë.

Jo çdo gjë që bëjmë dhe që bëhet përputhet me interesat dhe dëshirat e secilit prej nesh. Kjo është një nga veçoritë kryesore të Parlamentit, sidomos kur diskutohet për ato ligje që kërkojnë 94 vota, që kërkojnë një kompromis të gjerë, i cili po tenton të arrihet. Gjithsekush nga ne mund të ketë mendime të ndryshme për një pikë. Unë personalisht i kam shfaqur hapur këto mendime dhe më e rëndësishmja është të kuptojmë se këto mendime kthehen në vendime, kthehen në ligj në kontekstin e një kompromisi, në kontekstin e një vendimi të përgjithshëm, sepse asnjë prej mendimeve dhe vendimeve tona nuk ka vlerë absolute, por ato janë të diskutueshme dhe kanë elementet e tyre të kontestueshme, kanë relativitetin e tyre në kohë dhe në cilësinë e tyre, por vlerën absolute e marrin në kontekstin e një kompromisi, të cilin ne tashmë kërkojmë ta gjejmë në Parlamentin shqiptar, për të ndryshuar disa nga ligjet e rëndësishme kushtetuese të vendit tonë.

Unë mendoj se në vlerë absolute është dhe do të ngelet përsosja demokratike e procesit zgjedhor, krijimi i një procedure demokratike për zgjedhjet e ardhshme, gjë të cilën do të vazhdojmë ta bëjmë edhe në komision, edhe në ndryshimet e tjera që kërkon reforma zgjedhore, duke dhënë aty përgjegjësinë tonë dhe duke korrigjuar ato elemente, të cilat ngelen për t'u përmirësuar nga ndryshimet aktuale të paraqitura këtu përpara nesh.

Pikërisht, duke menduar dhe diskutuar në këtë mënyrë, unë shpreh pro votën time dhe të grupit tim, për ndryshimet kushtetuese që u paraqitën.

Falemnderit!

**Jozefina Topalli** – Falemnderit, zoti Shehu!

Zoti Gjinushi, urdhëroni!

**Skënder Gjinushi** – Të nderuar kolegë,

Sot nuk është një ditë historike për fitoren e parlamentarizmit, por është një ditë historike për shkatërrimin e tij.

Së pari, nga ana formale dhe procedurale Kuvendi po vihet përpara një akti të paprecedent të ndryshimit arbitrar të Kushtetutës, pa respektuar as afatet normale, të cilat kërkojnë të paktën tri javë për një ndryshim takse, ndërsa ne për 10 ditë duam të ndryshojmë nene të qenësishme të Kushtetutës.

Kujtojmë se u deshën 6 vjet për ta ndryshuar këtë Kushtetutë; u deshën 2 referendume për miratimin e saj; se të gjitha variantet që hidhen sot nëpër kafene janë shqyrtuar dhe debatuar gjatë dhe së fundi u votuan ashtu siç është Kushtetuta në fuqi. Këtë punë 6-vjeçare, këtë votim popullor e prish pa prituri një deputete pas një komunikimi telepatik me Kryeministrin, armikun numër një të Kushtetutës dhe të ligjshmërisë në vend, që nuk pati as mundësinë dhe as kurajën ta paraqiste propozimin e vet përpara seancës.

Kjo iniciativë, pra, frymëzohet nga ai që e bllokoi dy herë procesin kushtetues; që bëri grusht shteti në vitin 1998, për të bllokuar miratimin e saj; që e quajti atë pasaportë të së majtës, dokument të helenizimit; që në këta tre vjet ka përdhosur 14 herë dokumentin themeltar të shtetit.

Pra, nisma e paraqitur ka të njëjtat qëllime: prishjen e kushtetutshmërisë, vendosjen e të tëra pushteteve nën Kryeministrin, bërjen e tij të paprekshëm. Kjo bëhet në një kohë kur duket qartë e kundërta: se Kryeministri duhet të jetë pjesa më e kontrollueshme e qeverisjes së vendit; se mandati dhe pushteti i tij duhet të varen vetëm nga rezultatet në ekonomi, në politika sociale, në luftën ndaj korrupsionit; se vetëm kryeministrat e paaftë dhe të dështuar, kryeministrat e Gërdecit përpiqen ta zgjasin pushtetin e tyre me kontrollë arbitrare ndaj shumicës dhe institucioneve.

Pra, në një kohë kur Qeveria duhet të qe larguar, kur duhet të jepte llogari përpara Kuvendit dhe ligjit, ajo vë nën diktat Kuvendin, kërkon të kontrollojë Presidentin dhe shumicën nëpërmjet ndryshimeve të propozuara. Parlamentarizmi sot po komprometohet edhe nga vetë argumentet që propozuesit kërkojnë të japin. Nga një anë ofrohet një sistem zgjedhor që do të na çlirojë nga "Dushku" dhe që do të japë, sipas jush, një Kuvend politik dhe dinjitoz dhe jo si sot një të kalbur dhe, nga ana tjetër, i kërkohet këtij Kuvendi të kalbur të reformojë sistemin politik brenda 24 orëve.

Pikërisht, bashkimi i ndryshimit të sistemit zgjedhor me "paketën puç" që kërkon të kënaqë obsesionin e kryetarit të PD-së ndaj institucioneve të pavarura është gjeja më e papranueshme dhe më e kontestueshme për ne. Vjet në këtë kohë kemi theksuar se vendi nuk ka nevojë për të ndryshuar Presidentin, por Kryeministrin dhe ky Kuvend bëri të kundërtën. Edhe sot s'është koha për të dobësuar Presidentin dhe për të forcuar Kryeministrin, sepse kriza është në Qeveri dhe këtë po e paguajnë shqiptarët. Kryeministri aktual nuk bashkëjeton dot me asnjë president, as me aktualin që e zgjodhi vetë, pasi edhe ai nuk e mbështet për të mbuluar krimin e Gërdecit dhe korrupsionin qeveritar, sepse ai nuk përkrah tentativën e Kryeministrit për të ridominuar partinë.

Për moshën që ka, kryetari i PD-së nuk ka më ambicie për fitore në 2009-ën, por do, mbi të gjitha, garantimin e trashëgimisë dhe kjo realizohet vetëm duke pastruar partinë nga përkrahësit e Presidentit. Ky është qëllimi i kësaj pakete dhe kjo duket qartë nga përmbajtja e saj. Në të kërkohet që Presidenti të votohet nga 71 vota dhe kjo gjoja bëhet për të shmangur krizën. Ky argument nuk qëndron. Vetë praktika jonë tregoi qartë se zgjedhja e Presidentit me 84 vota nuk çon në zgjidhje, por kërcënimi për zgjedhje detyron politikën dhe shumicën të pranojë një president konsensual; detyron Kryeministrin të mos verë një ogiç të vetin si President. Opozita i kërkon dhe i provokon

zgjedhjet e parakohshme vetëm kur e ka të sigurt fitoren, çka ndodh kur Qeveria dhe qeverisja kanë humbur mbështetjen popullore. vendi është në krizë dhe zgjedhjet në këtë rast nuk janë fatkeqësi, por një zgjidhje për vendin. Kjo frikë për zgjedhje të parakohshme bëhet më qesharake po të kujtojmë se Presidenti i radhës do të zgjidhet në vitin 2012, një vit përpara zgjedhjeve parlamentare, dhe dihet që kurrkush nuk provokon zgjedhje një vit përpara dhe më pas, në 2017-ën, në një kohë me Parlamentin. Atëherë, rreziku i vetëm mbetet viti 2022. Shumica prej 84 votash, ju kujtoj, është një shumicë që kërkohet për të gjitha reformat, atëherë, le të heqim nenin 81, le t'ia lëmë Kodin Zgjedhor një shumicë të thjeshtë dhe pastaj të rikthejmë zgjedhjet si ato të '96-ës.

Të gjithë e dimë që bllokimi dhe degradimi i këtyre proceseve nuk vjen nga shumica e cilësuar, por vjen nga një njeri që nuk e do ligjin, nuk e do Kushtetutën dhe rregullat. Në vend që të ndryshojmë atë njeri ne kërkojmë që të ndryshojmë rregullat. Presidenti me 84 vota është një nga balancat e Kushtetutës, një nga shtyllat e saj. Pra, ky ndryshim është një ndryshim i nenit thelbësor dhe jo atij sipërfaqësor dhe ju duhet ta dini dallimin ndërmjet një ndryshimi plastik për heqje rrudhash nga një ndryshim për heqje organesh. Ju sot kërkoni të prekni, të ndryshoni organet jetësore të Kushtetutës. Ju po përpiqeni ta bëni Kryeministrin të paprekshëm nga mocionet. Propozuesit e paketës, nga njëra anë, thonë se duhet hequr kërcënimi për zgjedhje të parakohshme nga moszgjidhja e Presidentit, ndërsa, nga ana tjetër, vendosin kërcënimin për zgjedhje të parakohshme në rast se kërkohet të hiqet Kryeministri.

Pra, po nuk të pëlqeu kreu i Qeverisë edhe kur ai vret një fshat të tërë si në Gërdec, edhe kur shkatërron ekonominë, edhe kur shpërdoron fondet publike, edhe kur tallet me popullin për centrale bërthamore, përsëri nuk duhet hequr, sepse ndryshe deputetët humbasin mandatin.

Edhe ndryshimi i propozuar për Prokurorin e Përgjithshëm, i vetmi i pranueshëm, nuk ka nevojë të bëhet kushtetues. Është më se i justifikuar që ky ndryshim të bëhet në ligji organik "Për organizimin e Prokurorisë". Për të gjitha këto ne jemi kundër kësaj pakete.

Të nderuar deputetë,

Në rast se nuk do ta dëshironit këtë situatë, këtë ndryshim arbitrar, të dhunshëm dhe të paprecedent të Kushtetutës, zgjidhja është fare e thjeshtë: ndani sistemin zgjedhor nga paketa kushtetuese e PD-së. Kjo paketë "s'i duhet as dreqit" dhe ndryshimet në të veprojnë vetëm në vitin 2012. Kuvendi i ri i 2009-ës e ka të gjithë kohën e nevojshme për të bërë ndryshime me konsensus, pa dhunë, në rast se duhen, kështu nuk komprometoni as vetë sistemin, i cili serviret si sistem që do të evitojë "Dushkun" dhe trafikun e deputetëve. Por, ndërkohë, po votohet me vota të blera, pra me trafik. Madje, po mbushen tani listat në kafene me ata që janë gati të shkëmbejnë votën, pra, me "këlyshët e penduar".

Vetë sistemi mund të bëhet lehtësisht anti "Dushk" dhe konsensual me disa përmirësime. Kjo do të rikthente parlamentarizmin. Edhe mocioni i ri nuk sjell asgjë të re, sepse paraqitja e mocionit nuk varet nga formulimi që mund t'i bëhet në Kushtetutë, por nga boria e deputetëve dhe nga pushtimi i Qeverisë. Ky Kryeministër do të bjerë sapo të kuptohet se ai nuk e lëshon pushtetin jo nga trimëria, por nga frika. Paketa vetëm komprometon reformën zgjedhore dhe kushtetutshmërinë e vendit, prandaj ne jemi kundër paketës së PD-së.

**Jozefina Topalli** – Në emër të Grupit të PR-së?

Urdhëroni, zoti Mediu!

**Fatmir Mediu** – Sot, të nderuar deputetë, gjatë drekës me Presidentin Mesiq një përfaqësues i lartë tregoi një histori të viteve '90: "Në Tiranë ishte e vështirë që të hapej një xhami e re, edhe për shkak të disa reaksioneve që kishte Tirana në atë kohë, dhe u mor një iniciativë nga PD-ja për të vendosur një arkë përpara xhamisë, ku secili hidhte nga një kontribut, aq sa të mundte. Për çudi, pasi përfundoi i gjithë ky proces, u vodh arka dhe u mor vesh që e kishte vjedhur një profesor i marksizëm-leninizmit. Kur vajtën

e takuan, për të marrë lekët që ishin mbledhur, profesori tha se do të hapte një xhami, pasi kishte dy vjet që po studionte Kuranin.”

Pra, profesori i marksizëm-leninizmit do të bëhej hoxhë. Edhe ky Parlament çdo seancë do të nxjerrë nga një hoxhë të ri marksist-leninist, nga një patriot apo edhe nga një hero kombëtar. Historia e politikës shqiptare nuk fillon sot as me qaravitjet e ndonjë deputeti, që e paskan prurë pa dashje në Parlament, as me patetizmin e ndonjë tjetri, që do të shpëtojë maxhorancën. Kjo histori politike ka 17 vjet dhe gjithsecili është përpjekur të ndërtojë atë që duhet, sipas bindjes që ka. Por, ne po vijmë në një moment shumë të rëndësishëm të rolit të deputetit, që ka të bëjë jo thjesht me ligjbërjen, por ka të bëjë me Kushtetutën dhe Kushtetuta, natyrisht, nuk është një letër e pavlerë. Kushtetuta është një marrëdhënie e qytetarit me shtetin, një marrëdhënie e qytetarit me institucionin, ku, minimalisht, këtij qytetari duhet t'i jepet mundësia që të kuptojë se ku e ka vendin e vet. Pra, nuk është një letër pa vlerë, por është edhe një marrëdhënie ndërinstitucionale për të balancuar pushtetet, për të garantuar pavarësinë dhe kontrollin reciprok, në mënyrë që shteti të funksionojë në shërbim të atij që është qytetari. Unë mendoj, pa dyshim, njësoj si kolegët e tjerë, që ky proces kishte nevojën për ta kuptuar qytetarët dhe jo më deputetët, të cilët duhet të vijnë dhe ta votojnë, ndoshta edhe pa e lexuar. Çështja është që ndonjëherë belaja është ta kërkosh atë me duart e tua dhe ndodh kështu edhe tek ne. Ndodh kështu për faktin, sepse, jo rrallë në këtë Kuvend, qëllon që asgjë të mos ketë më vlerë dhe e pamoralshmja të marrë qytetarinë. Ka nga ata që qanin kur u hodh busti i diktatorit, sot janë bërë demokratë të mëdhenj. Ka nga ata, të cilët spiunonin njerëzit dhe i fusnin nëpër burgje, kurse sot marrin vlerën dhe parinë. Kjo është fatkeqësia e politikës shqiptare që asnjëherë nuk i bëri analizën vetes se “kush është kush” dhe për çfarë është.

Megjithatë, të nderuar kolegë deputetë, unë firmosa jo thjesht si kryetar i PR-së dhe vetëm si ai, por si deputet i këtij Kuvendi për një amendament, që u përcoll nga disa kolegë me bindjen që duhet të kemi një President që të qëndrojë mbi palët. Po ashtu shikoj që kur vjen momenti për të gjykuar për vlerën e gjithsecilit në këtë Kuvend dhe vendin që ai duhet të ketë, për fatin e keq, është një heshtje varri, ku secili nuk do t'ia dijë, kur gjysma nga krahu i majtë dhe gjysma nga krahu i djathtë me këtë sistem të pavlerësuar preferencial, të paktën proporcional, nuk do të jenë më në Kuvend dhe e pranojnë këtë sakrificë të madhe. Kjo është çështje e tyre.

Për sa i përket këtij sistemi, unë kam bindjen se ai krijon probleme në jetën politike pluraliste shqiptare të ndërtuar me mundim në 17 vjet. Megjithatë, secili përpiqet që të bëjë hesapet se si duhet të përçojë idetë dhe qëndrimet e partisë së vet politike në jetën politike shqiptare dhe po i jap përgjigje ndonjë deputeti që e ka shqetësim. As i është kërkuar dhe as nuk i kërkohet PD-së t'i merret ndonjë gjë. Ka pasur vetëm një diskutim shumë parimor brenda kësaj maxhorance, e cila nuk u ndërtua në këtë Kuvend, por erdhi në këtë Kuvend pas 8 vjetësh të mundimshëm. Po i jap përgjigje ndonjërit që nuk e dinte se ku ishte kjo maxhorancë kur ishte në opozitë, ndonjërit që edhe e pështynte këtë maxhorancë kur ishte në opozitë, ndonjërit që, pa dyshim, nuk i ka vlejtur ndonjëherë dhe, pavarësisht se sot është në një grup të PD-së apo të PR-së, apo të ndonjë grupi tjetër, këtë e quan veresie, dhe kur e merr veresie, veresie do ta lëshosh. Por unë dua të them që ne kërkuam, si njerëz koshientë brenda kësaj maxhorance, të mos presim simpati politike në degën ku qëndrojmë të gjithë së bashku, për të realizuar ato që janë qëllimet shqiptare, dhe brenda kësaj secili të marrë atë që i takon dhe të mos ketë merak kurrkush se do të merret ajo që nuk i takon njërit subjekt apo një subjekti tjetër.

Do t'i thosha ndonjë kolegu të penduar që është në Kuvend, se e paskan prurë të tjerët, se duhet të jetë i penduar në raport me ata që beson se janë votuesit e tij, për një arsye shumë të thjeshtë, sepse një herë të vetme duhet të tregojë se është deputet.

**Jozefina Topalli** – Në emër të Grupit të PS-së, urdhëroni zonja Leskaj!

**Valentina Leskaj** - Të nderuar kolegë deputetë,

Natyrisht, ndryshimet në Kushtetutë, si ligji themeltar i shtetit, janë një ngjarje e rëndësishme për vendin, ndaj dhe kjo seancë merr rëndësi të veçantë.

Duke diskutuar sot për ndryshimet kushtetuese, ne konsiderojmë se i japim udhë dhe kodifikojmë një proces që, mbi të gjitha, të jetë i dobishëm për vendin dhe të ketë të gjitha shanset që t'i rezistojë kohës. Ne besojmë se sot më shumë se kurrë vendi ka nevojë për reforma dhe të kuptuarit e kësaj nevojë nga forcat politike, që rezultoi në një frymë më bashkëpunuese, e dha rezultatin e parë me marrjen e ftesës për në NATO dhe besoj se këtë nuk mund ta mohojë askush. Natyrisht, kjo është një premisë e parë për të realizuar me sukses reformat integruese që kemi përpara në rrugën drejt BE-së, gjithashtu.

Angazhimi në këtë reformë është edhe një test i rëndësishëm i pjekurisë së politikës shqiptare, e cila, ndryshe nga herët e tjera, që ka dështuar të ngrejë konsensus politikë pa ndërmjetësinë ndërkombëtare, këtë herë e gjeti vetë rrugën për të bërë një reformë. Ne besojmë se kjo është një ndërmarrje që del përtej kufijve të interesave të vogla partiake dhe orientohet nga interesat e mëdha të vendit. Ky ka qenë motivi shtytës që Partia Socialiste u bë nismëtare e paketës për reformën zgjedhore, si dhe për atë në drejtësi.

Ne e kemi konsideruar prioritare nevojën që ka vendi për reforma të mëdha dhe për këtë jemi ulur pa komplekse e paragjyime në tavolinë. Nuk kemi komplekse ta bëjmë këtë edhe në të ardhmen, pasi e konsiderojmë konsensusin jo vetëm një nevojë për të prodhuar reforma cilësore e të qëndrueshme, por edhe si një vlerë e forcë. Dhe kjo nuk ka të bëjë thjesht me numrat, nuk ka të bëjë me faktin që na duhen 94 vota për të ndryshuar Kushtetutën, por me cilësinë e demokracisë e, natyrisht, me nevojën që reformat të jenë të qëndrueshme dhe të pakthyeshme.

Gjithsesi, askush nuk mund të thotë në këtë sallë se si mund të bëhen reforma në këtë vend, sidomos ato që lidhen me Kushtetutën, pa konsensus.

Për t'u kthyer te propozimi ynë për reformën zgjedhore, dua të them se kjo paketë vjen përmes një procesi të hapur e të konsultuar gjatë me ekspertë e përvoja të vendeve të zhvilluara, ku është diskutuar në mjedise politike e në publik. Këtu u fol shumë për sistemin zgjedhor, u thanë shumë të pavërteta, në fakt. Nuk them ndonjë gjë të re, kur pohoj se ndryshimet e propozuara lidhur me sistemin zgjedhor do ta ndajnë përfundimisht politikën dhe vendin nga një sistem që ka sjellë deformime të mëdha. Do ta ndajnë vendin nga sistemi i korrupsionit zgjedhor e politik, që e bën çdo të zgjedhur të ndjehet keq edhe kur ka fituar me ndershmëri, po si pjesë e një sistemi që prodhon pandershmëri në zgjedhje. Projekti i ri e ndan vendin nga një sistem që, për shkak të pamundësisë për të bërë zgjedhje të lira e të ndershme, ka cenuar të drejtat e votuesve dhe kjo është shumë e rëndë për një sistem demokratik dhe ne nuk jemi të vetmit që i besojmë këto.

Nga ana tjetër, me propozimet e sotme ne jemi në kohë për të garantuar një reformë të plotë e cilësore, që u hap rrugë ndryshimeve të tjera. Them të plotë e cilësore, pasi nga ndryshimet që po bëjmë sot në Kushtetutë, derivojnë ndryshimet e nevojshme në Kodin Zgjedhor, të cilat, natyrisht, kërkojnë kohë që të realizohen.

Ne e kemi thënë se jemi kundër një reforme të minutës së fundit dhe këtë po bëjmë sot. Po i japim kohë vetes, dhe kur them vetes nuk kam parasysh vetëm Partinë Socialiste si propozuese, që reforma zgjedhore të përfundojë në kohë, që partitë politike të kenë gjithë kohën e nevojshme për t'u orientuar e përgatitur për zgjedhje, që zgjedhësit, dhe kjo është shumë e rëndësishme, të kenë kohë të njihen me sistemin.

Natyrisht, të gjitha këto ndryshime nuk do të kishin asnjë vlerë nëse Qeveria nuk do të plotësonte detyrimet e saj për infrastrukturën zgjedhore, nuk do kishin asnjë vlerë pa zgjidhur çështjen e kartave të identitetit dhe të regjistrimit, të cilat janë me vonesë dhe çdo ditë që kalon vë në pikëpyetje standardet zgjedhore për vitin 2009. Për këtë Qeveria duhet të vijë të raportojë në Parlament, siç edhe ne e kemi kërkuar.

Pse ne propozojmë një sistem të tillë?

Në radhën e modeleve të shumta elektorale të konsultuara e debatuar, sistemin proporcional rajonal me lista shumëmemërore, që ne propozojmë e gjejmë si sistemin më të përshtatshëm në kushtet e vendit tonë. Pa u ndalur në të gjitha argumentet që e bëjnë sistemin e propozuar të avantazhuar, për shkak se të gjitha argumentet tashmë janë jo thjesht deklaruar, por debatuar edhe publikisht, ajo që ka rëndësi është fakti që ky projekt heq çdo mundësi për transferimin dhe tjetërsimin e votës, siç ka ndodhur në të kaluarën. Ky sistem u jep mundësinë deputetëve të jenë ligjvënës dhe duke qenë rajonal mundëson edhe ruajtjen e lidhjeve me zgjedhësit, kontributin e tyre në zhvillimin e rajonit, pa i kthyer ata në këshilltarë komunarë, u jep mundësi votuesve të zgjedhin programin dhe ekipin, alternativën përfaqësuese, jo të fortin apo të pasurin, duke u dhënë kështu më shumë vlerë politikës dhe të zgjedhurve.

Dëshiroj të them se kjo nuk është një nismë anti, nuk synon dobësimin apo eliminimin e ndokujt. Përkundrazi, ky është një sistem pro. Është pro rregullave të lojës në zgjedhje, pro peshimit real të forcave politike, ku secili merr atë që ka në të vërtetë, pro një qeverisjeje të qëndrueshme, që do të thotë më shumë garanci për reforma cilësore, pro një shpërndarjeje më të balancuar territoriale të ngjyrave politike në vend, pro më shumë grave në Parlament. Natyrisht, ky sistem është pro votimit për alternativa, programeve dhe ekipeve jo për interesa të vogla vetjake, ndonjëherë korruptive.

Duke u kthyer te paketa që ka të bëjë me Presidentin e Republikës dhe ajo për Prokurorin e Përgjithshëm e të tjera, unë besoj se propozimet që vijnë sot nuk janë një "rrufe në qiell të pastër". Është e vërtetë që nisma ka ardhur vetëm këto dy- tre javë në Kuvend, është gjithashtu e vërtetë që nuk ka pasur një debat të mirëfilltë të organizuar me seanca dëgjimore, që do ta dëshironim të gjithë, por, në fakt, është po aq e vërtetë që për këto çështje ka kohë që flitet e debatohet, edhe pse jo në mënyrë të strukturuar.

Gjatë krizës për zgjedhjen e Presidentit është diskutuar për ndryshime në Kushtetutë, siç është diskutuar edhe gjatë krizës së Prokurorit të Përgjithshëm për nevojën e kufizimit të mandatit. Ajo që merr vlerë sot është fakti se ne nuk mund e nuk duhet të presim sa të ndodhin krizat që të reflektojmë. Duhet krijuar mjedisi antikrizë dhe një politikë e mençur na çon drejt një përjasjeje prevenuese, e cila realizohet vetëm përmes reformave.

Ne i vlerësojmë këto ndryshime, pasi ato përmirësojnë sistemin, ndaj edhe i kemi pranuar propozimet e maxhorancës dhe kemi votuar për to në Komisionin e Ligeve, siç do bëjmë edhe këtu. Ne jemi këtu për t'i dhënë Shqipërisë reforma, pavarësisht nga interesat tona, ndaj në emër të Grupit Parlamentar të PS-së, dua të ftoj gjithë kolegët deputetë që ta votojnë projektin që kemi përpara.

Falemnderit!

**Jozefina Topalli** – Falemnderit, zonja Leska!

Urdhëroni, zoti Berisha!

**Sali Berisha** – Të nderuar deputetë,

Zonja Kryetare,

Të nderuar qytetare dhe qytetarë shqiptarë që ndiqni sot këtë seancë,

Dua të theksoj se kjo seancë vjen si një zhvillim kulmor i një procesi ndoshta më të përgjegjshëm në tërë rrugën tonë, përpjekjet tona për ndërtimin e demokracisë dhe të shtetit ligjor. Proces të përgjegjshëm do ta quaja unë, sepse në këtë Parlament jemi po ne që vetëm një vit më parë masnim me lupë çdo germë, hidhnim, kthenim e stërkthenim. Por ndodhi diçka shumë e thellë, shumë e madhe, e cila u bë imperative për një ndryshim madhor, rrënjësor të kulturës politike të këtij vendi dhe ky ishte procesi i anëtarësimit të vendit në NATO. Ne duhet t'i shohim gjërat drejt në sy. Ishte kjo ndjenjë e thellë përgjegjësie e forcave politike, në vetëdijen e të cilave ky projekt mbështetej nga 95% e shqiptarëve, se ato nuk mund të linin asnjë përpjekje pa bërë për ta çuar Shqipërinë aty ku meritonte. Unë them se ky proces është ndër më të përgjegjshmit, sepse u ndërmor në mënyrë të vetvetishme dhe ka nisur që kur në horizont u dukën qartë rrezet e para të marrjes së ftesës. Është ky proces, i cili ka çuar së bashku pozitën

dhe opozitën në tribunat e Brukselit për të bërë avokatinë e këtij projekti. Është ky proces, që bëhet në mënyrë të vetvetishme nga forcat politike të vendit dhe unë mendoj se ajo që spikat më shumë këtu është shkalla e lartë e përgjegjësisë që prodhohet sot në këtë vend.

Le të vijmë te ndryshimet. Unë jam njeri që instinktivisht nuk merrem me histori, por asnjëri prej nesh nuk mund të harrojë proceset e mundimshme, në të cilat kaloi Shqipëria gjatë viteve, faktin që kaloi nga kriza në krizë, nga ndjellëkriza në ndjellëkrizë. Çfarë po bëjmë ne tani? Të tjerat janë të pabazuara. Ne po përpiqemi që ky vend ta ketë rrugën më të lehtë. Ne po përpiqemi të parandalojmë krizat. që ky vend të jetë një vend normal, siç e meriton. Absolutisht, asgjë tjetër. Cili mund të më thotë mua tani se sistemi zgjedhor nuk na krijoi probleme? A nuk është ky që na damkosi dhe na bëri qesharakë përpara gjithë Europës, kudo që shkonim? A nuk është ky që një lokalitet të ndershëm të Lushnjës e bëri të famshëm në të gjithë botën si “Dushk”? A nuk jemi ne të gjithë që e ngjyem kafshatën në këtë “Dushk”? Po, sigurisht, zotërinj. Tani urdhëroni të kthejmë faqen, sepse jemi vend tjetër, sepse jemi vend që kemi marrë një ftesë për në NATO dhe po bëjmë një gjë shumë të madhe, po realizojmë atë për të cilën shqiptarët kanë vuajtur më shumë se çdo komb tjetër në dekada dhe shekuj. Kudo, në Parlamentin Europian, në Kongresin Amerikan, kudo “Dushku”, “lugati i Dushkut”, “damka e Dushkut”. E hoqëm, zotërinj, e shijuam si e shijuam, por tani duhet hequr. Ne jemi në politikë për t’u ndarë me ato gjëra që nuk shkojnë. Pse i personalizoni gjërat?

Ja ku janë këta zotërinjtë, të cilët kanë marrë më shumë vota se unë, por në pushtet jam unë. Kjo është e vërteta, unë nuk i mohoj gjërat.

*(Ka reagime në sallë.)*

Unë që jam në pushtet, çfarë leverdie personale kam për të ndërruar sistemin? Jo, zotërinj, ka interesa vendi, ka interesa kombi, ka interesa shoqërie dhe ne vendosim bashkërisht për atë krizë, sepse krijoi krizë “Dushku”, krijoi turp, duke na damkosur, krijoi krizë dhe krizë të thellë. A ka ndodhur ndonjëherë të ngrihet Parlamenti Europian dhe të diktojë mënyrën e zgjedhjes? Kurrë! Po “Dushku” e solli atë, prandaj ne ndahemi me “Dushkun”.

Së dyti, si ndahemi? Ndahemi me një sistem, i cili është sot në 5/6 e vendeve të këtij kontinenti, me sistemin proporcional.

Më falni, merrni hartën elektorale! Ky sistem është spanjoll, por ka një meritë të jashtëzakonshme. Zotërinj, unë nuk e kuptoj se nga një anë thoni që po ikën përfaqësuesi i popullit. Pikërisht për të mos ikur përfaqësuesi i popullit po bëjmë rajonin dhe po dërgojmë deputetët në rajon. Ky sistem ka një meritë të jashtëzakonshme, sepse rajoni nuk do të ketë më vetëm ngjyrën blu apo rozë, por çdo votë, pavarësisht se për kë jepet, do të kushtojë, do të përfaqësohet në këtë Parlament. Çfarë ane negative ka kjo, më thoni?

Ky sistem, zotërinj, i jep vendit qeveri, por i jep vendit edhe opozitë dhe në mënyrë absolute në një hapësirë më të qartë se në çdo sistem tjetër, sikundër jep qeveri të qëndrueshme. Atëherë, pse e demonizoni këtë? A nuk është Qeveria ajo që solli “Dushkun” dhe ua imponoi gjithë të tjerëve? Çfarë interesi personal ka Qeveria të largohet nga “Dushku”? Ajo ka interesin e shtetit ligjor. Çfarë do të thoni ju tani, kur ne për vite aplikuam një sistem i cili u kalohej të drejtave njerëzore dhe unë ju mirëkuptoj se kam respekt për luftën që keni bërë për to, por ama mos harroni se në sistemin që kishim ne një qytetari në Ersekë i kushtonte vota 0,5, kurse tjetrit në Tropojë apo diku tjetër i kushtonte 1,7. Po këta ishin të barabartë. Jo, ai deformonte forcën elektorale në mënyrën më të papranueshme, kurse ky sistem e barazon atë. Pra, ne po ndahemi nga një sistem tjetër në emër të një stabiliteti më të madh demokratik dhe këtu kanë një meritë të madhe të gjithë ata që punuan për të.

Vijmë te çështja e dytë, çështja e Kryeministrit. Po ju them diçka se ju jeni kontradiktorë në ato akuza që më bëni sa nuk ka. Një herë thoni që ky ka të gjitha pushtetet, pastaj thoni se ky po i merr të gjitha pushtetet. Po nuk mund të punoj unë për Edi Ramën, zotërinj, as për kryetarin e Partisë Socialiste. Hiqeni nga mendja! Dhe të jeni

të sigurt që as kryetari i Partisë Socialiste nuk punon për Sali Berishën, përkundrazi punon me çdo kusht që t'i marrë pushtetin Sali Berishës, sikundër Sali Berisha punon me çdo kusht që të fitojë zgjedhjet në mënyrë të ndershme.

*(Ka reagime në sallë.)*

Zotërinj, çfarë kujtoni ju se kryetarët e partive të vogla do të bëhen kryeministra? Kjo nuk ndodh në asnjë vend të botës. A doni të diskutojmë apo jo? Unë kam respekt për ju, por nuk mund të ndodhë kurrë të mendohet që një populli të lirë t'i ndodhë kjo. Kurrën e kurrës! Pse i bëni këto? A po ecim përpara, apo po shkojmë prapa? Ne po ecim përpara. Në çdo vend demokratik, në çdo traditë demokratike Kryeministri i vendit është ai, partinë e të cilit e kanë votuar më shumë. Prandaj t'i lëmë iluzionet. Çfarë po bëjmë ne? Unë ju them atyre që akuzojnë: Bëhuni parti kryesore dhe gëzojeni, meqenëse po e quani se po e gëzoj.

Ne po vendosim sistemin proporcional spanjoll. Shkoni dhe lexoni nenin e Kryeministrit spanjoll. Por çfarë bëmë ne? Ne nuk morën vetëm atë, morëm edhe nenin e mocionit konstruktiv. Në Kushtetutën spanjolle Kryeministri i Spanjës, pasi merret vesh me Qeverinë, e çon vendin në zgjedhje pa asnjë lloj hezitimi, kur të dojë. Ne e morëm këtë nen, por morëm edhe nenin tjetër, që në qoftë se Kryeministri lajthit, është mocioni konstruktiv, bëni 71 vota dhe vini Kryeministrin tjetër. Por parlamentarizmi është parlamentarizëm, republika parlamentare është republikë parlamentare dhe kreu i maxhorancës edhe në Kushtetutën aktuale është përgjegjës për politikën shtetërore të vendit. Mund t'ju them që është nga rastet që bëhet tamam në përputhje me këtë Kushtetutë, prandaj është naive të mendoni se unë po punoj për kryetarin e Partisë Socialiste. Mos i personalizoni gjërat. Me këto nene Kushtetuta e Shqipërisë merr tërësisht ngjyrat perëndimore që duhet t'i kishte. Ajo del nga një kushtetutë e ndikimeve rajonale dhe merr standardet e Kushtetutës spanjolle, gjermane, çeke, sllovaqe etj. Absolutisht, po!

Vazhdojmë tani me Presidentin. Mos u përpiqni as me thika e as me pyka. Zoti Bamir Topi ka qenë, është dhe do të mbetet një bashkëpunëtor imi. Në përvojën time, nuk gjendet njeri në Shqipëri që të ketë ngrënë më shumë thika dhe pyka nga bashkëpunëtorët se unë. Por unë mbetem gjithnjë besnik dhe vendos besimin të parin, prandaj shqiptarët më duan më shumë se ju. Sepse shqiptarët janë njerëz të besimit. Vendosin besimin të parin dhe nuk lëvizin prej tij. Çfarë mendoni ju, se unë po punoj për kryetarin e PS-së? Kjo është absurde. Sepse, së pari, çfarë po bëjmë ne sot? Ne po i heqim vendit një nen krize. A e kuptoni se në dy proceset e fundit, kur kemi qenë bashkë në tryezë, sa depersonalizuose ka qenë përpjekja për zgjedhjen e Presidentit? Bëj lista, merr lista, merr të panjohur. A ishin punë serioze ato? Unë, Sali Berisha, dola me tezën që Presidenti të zgjidhej nga populli. Po kush isha unë? Unë isha ai që kisha shkruar ligjin, kur isha President, që të mos zgjidhet nga populli, por të votohet me 80 plus 1, ndonëse jam zgjedhur në këtë Parlament me 104 vota.

Por, pse e thashë? E thashë sepse neni i tri të pestave nuk mund të pranohej kurrë. Ai ishte një nen krize. Imagjinoni se kë fuste në krizë! Institucionin kryesor të stabilitetit të vendit. Shikoni ku ra Shqipëria. Ra në atë shkallë, sa që shtyllën qendrore të stabilitetit e fuste në elektrohok që tre muaj para, gjersa Presidenti të zgjidhej dhe ne rrinim këtu, votuam apo s'votuam, quhet votim apo s'quhet votim. Gjëra të tilla nuk mund të bëhen kurrë.

Ishin dy platforma: e imja që për zgjedhjen nga populli. Opozita e kundërshtoi në unison, përveç zotit Blushi. Zotërinj, mes nenit të krizës dhe zgjedhjes si rasti gjerman, kë duhet të zgjedhim? Të jeni të bindur se Gjermania zgjedh në krye të vendit nga burrat ose gratë më serioze të vetat. Siç e zgjedh Italia. A e dini se Xhorxho Napoletano ka një kompetencë që nuk e ka asnjë nga presidentët e tjerë? Qeveria italiane është shumë e fuqishme, vepron me dekrete. Por asnjë dekret nuk çohet dot në Parlament pa qenë firmosur nga Presidenti. Ai ka veton para, që është veto absolute. Vetoja e Parlamentit kalohet edhe me dy votime. Kushtetuta italiane i ka njohur Presidentit këtë kompetencë dhe ai zgjidhet me 35 votime, po që e nevojshme, me 50 për qind plus 1.



Nuk është mënyra e zgjedhjes ajo që përcakton kompetencat e Presidentit. Ato, nga alfa tek omega, janë të caktuara në Kushtetutën e vendit. Pse shqetësoheni, pse po heqim një nen krize?

A e absolutizon kjo pushtetin e një partie? Jo. Po ju jap një shembull. Në një vend mik, më i avancuar se ne, opozita mori presidentin. Pse e mori? Sepse opozita vuri një gjykatës kushtetues. Qeveria e kishte shumicën, por te presidenti e humbi. Kjo qe vota e fshehtë. Dhe ai është një burrë shumë i respektuar sot. Dhe u zgjodh me 50 plus 1.

Ka edhe një gjë tjetër shumë të madhe në këtë reformë. Prapë dal te NATO-ja, se ajo është për të gjithë ne projekti madhor. Ju jeni dëshmitarë se ftesa është ftesë, por, po nuk bëre detyrat e shtëpisë, ke probleme. NATO-ja ka një filozofi olimpikë, nuk të kërkon shumë gjëra, por ato që të kërkon janë kardinale. Në këtë mënyrë ne shkojmë me një detyrë të madhe shtëpie të bërë. Se cili do të jetë vendimi i tyre, unë nuk e di, por ne iu përgjigjëm asaj ftese në mënyrën më dinjitoze, më të qytetëruar.

Unë ju falënderoj për të gjitha dhe ju ftoj ta votojmë paketën, se ia kemi lehtësuar rrugën këtij vendi. Mos u merrni nga mëngjesi në darkë me Sali Berishën. Dua t'ju them se nesër i gjithëfuqishmi mund të më thërrasë në banesën e tij dhe unë do ta falënderoj dhe do të shkoj me vrap. Por Zoti mund të më japë edhe tridhjetë vjet të tjera hallvë. Harrojeni se unë dal nga politika pa më nxjerrë votat.

**Jozefina Topalli** – Nisim votimin e paketës së ligjeve të sjellë këtu nga Komisioni i Ligjeve, pastaj iniciativën e ardhur. Hapim votimin në parim për paketën.

Mbyllet votimi. 117 pro, 14 kundër, 4 abstenime, 2 nuk morën pjesë në votim.

Miratohet paketa në parim.

Kalojmë te votimi nen për nen.

Neni 1.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

118 pro, 13 kundër, 1 abstenim, 3 nuk morën pjesë në votim.

Kuvendi miraton nenin 1.

Kalojmë te neni 2, me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

118 pro, 13 kundër, 1 abstenim, 3 nuk morën pjesë në votim.

Kuvendi miraton nenin 2.

Kalojmë te neni 3.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

118 pro, 12 kundër, 1 abstenim, 3 nuk morën pjesë në votim.

Kuvendi miraton nenin 3.

Kalojmë te neni 4.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

118 pro, 13 kundër, 1 abstenim, 3 nuk morën pjesë në votim.

Kuvendi miraton nenin 4.

Kalojmë te neni 5.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

105 pro, 24 kundër, 4 abstenime, 3 nuk morën pjesë në votim.

Kuvendi miraton nenin 5.

Kalojmë te neni 6.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

115 pro, 16 kundër, 1 abstenim, 5 nuk morën pjesë në votim.

Kuvendi miraton nenin 6.

Kalojmë te neni 7. Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.  
116 pro, 14 kundër, 3 abstenime, 3 nuk morën pjesë në votim.  
Kuvendi miraton nenin 7.  
Kalojmë te neni 8.  
Hapet votimi me elektronikë.  
Mbyllet votimi.  
117 pro, 14 kundër, 6 abstenime, 3 nuk morën pjesë në votim.  
Kuvendi miraton nenin 8.  
Hapet votimi për nenin 9.  
Mbyllet votimi.  
117 pro, 12 kundër, 4 abstenime, 4 nuk morën pjesë në votim.  
Kuvendi miraton nenin 9.  
Kalojmë në votimin e nenit 10.  
Hapet votimi.  
Mbyllet votimi.  
114 pro, 14 kundër, 4 abstenime, 4 nuk morën pjesë në votim.  
Hapet votimi për nenin 11, për hyrjen në fuqi.  
Mbyllet votimi.  
116 pro, 12 kundër, 2 abstenime, 6 nuk morën pjesë në votim.  
Hapim votimin me elektronikë në tërësi.  
Mbyllet votimi.  
115 pro, 17 kundër, 3 abstenime, 1 nuk votoi.  
Kuvendi miraton në tërësi paketën kushtetuese.  
Kjo është një nga reformat më të mëdha. Falemnderit të gjithëve për kontributin tuaj! I keni bërë një shërbim të jashtëzakonshëm vendit dhe shtetit tonë të përbashkët!  
Edhe një herë, falemnderit të gjithëve dhe urimet më të përzemërta!

*(Seanca u mbyll në orën 11:00)*